

**CALL YOUR COUNTRY**  
 FOL ME VENDIN TËND  
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.  
**WIND**  
 Informacione në wind.it



E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.10 - NOVEMBRE/MËNTOR 2009 - € 1,50

# shqiptari i italisë

*l'albanese d'italia*

**CALL YOUR COUNTRY**  
 FOL ME VENDIN TËND  
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.  
**WIND**  
 Informacione në wind.it

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543

## OLEN CESARI

### “Të nxisim kulturën tonë”


Violinisti gjenial që prej vitesh luan krah artistëve më të mëdhenj italianë, i mëshon rëndësisë që merr promovimi i kulturës sonë në Itali nga ana e artistëve që jetojnë e punojnë këtu



## ANILDA IBRAHIMI

### “Italisht, por me temë shqiptare”

Pas romanit befasues “Rosso come una sposa” shkrimtarja shqiptare me banim në Romë, penë italiane, i kthehet lexuesit me “L'amore e gli stracci del tempo”. Botuar sërish nga Einaudi, edhe pse i shkruar drejtpërdrejt në italisht, është sërish një temë dashurie dhe dhimbjeje që vjen nga Ballkani



**WESTERN UNION** | *yes!*



[www.stranieriinitalia.it](http://www.stranieriinitalia.it)  
 faqet internet të emigracionit

nga Ketu BIÇOKU

Më 30 shtator, pa asnjë shtyrje afati apo shtrirje të legalizimit edhe për kategori të tjera punonjësish (gjëra të kërkuar nga shumë palë), u mbyll faza e parë e legalizimit të bashkëpunëtoreve shtëpiake. Sipas të dhënave të ministrisë së brendshme deri më 24.00 të kësaj date u paraqitën 294.744 kërkesa për legalizimin e bashkëpunëtoreve familjare. Kërkesat e paraqitura janë kryesisht për punëtorët për mbajtjen e shtëpisë, të ashtuquajturat colf, 180.408 dhe vetëm 114.336 janë për badante. Përsa u përket kombësive të punonjësve për të cilët është kërkuar legalizimi, një e katërta e tyre janë nga Ukraina dhe Maroku. Për shqiptarë janë paraqitur vetëm 3,78% e kërkesave. E thënë ndryshe, është kërkuar legalizimi për 11.147 bashkëpunëtorë familjarë shqiptarë.

Numri i kërkesave të paraqitura gjatë shtatorit, treguan se nga sanatoria nuk përfituan as gjysma e atyre që mendohej fillimisht. Për arsye të ndryshme, nga kufiri i lartë i të ardhurave

# SANATORIA FAZA E DYTË

minimale të punëdhënësve, minimumi i orarit prej 20 orësh që çdo punëdhënës duhet t'i siguronte punonjësit, çështja e strehimit, kontributet deri te softueri i ministrisë që nxjerr probleme.

Tani fillon faza tjetër ajo e pritjes, që senatorët apo flukset e viteve të shkuara kanë treguar se mund të zgjasë shumë, muaj të tërë. Megjithatë ekziston shpresa se mund të mos ndodhë si më parë, madje që javën e parë të tetorit për ndonjë klandestin dokumenti i qëndrimit nuk është më një mirazh. Në mbarë Italinë, Sportelet Unike kanë nisur të lënë takimet me punë-

hënës dhe punëmarrës për nënshkrimin e kontratës së qëndrimit. Në fakt kërkesat kanë nisur të përpunohen që më 1 tetor, dhe Kuesturat, që kanë për detyrë të verifikojnë që punonjësit nuk kanë ndonjë precedent që mund të pengojë legalizimin e tyre, kanë filluar të japin vlerësimet mbi kërkesat. Nëse mendimi i kuesturës është pozitiv, Sporteli Unik për Imigracionin nis datën e takimit. Takimet kanë nisur të jepen edhe në qytetet me më shumë kërkesa si Milano e Roma, për të cilat ministria e Brendshme shpreson të përfundojë, maksimumi, brenda një viti.

"Takimet e para janë caktuar për nga fundi i muajit, në mënyrë që t'u jepet të gjithëve koha për të marrë lajmërimin. Në krahasim me flukset, rrugëtimi i praktikave të legalizimit është shumë më i shpejtë sepse nuk ekziston kalimi nga Qendrat e Punësimit dhe Drejtoritë Provinciale të Punës" - shpjegon Antonio Quarto që drejton Sportelin Unik të Milanos.

"Takimet e para i kemi caktuar nga mesi i muajit tetor e tutje, - shpjegon përgjegjësi i Sportelit Unik të Romës - do të presim punëdhënës e punonjës çdo ditë e shpresojmë që e njëjta gjë të bëhet edhe në INPS në

## JO RACIZMIT

### LEGISTI GENTILINI DËNOHET PËR RACIZËM

**Gjykata e Venecias "shtytje për racizëm" gjatë Festës së Popujve 2008**

**Avokati i tij: "Nuk e kishte me të keq. Ishin ide për integrim"**

Ungjilli i deklamuar nga Giancarlo Gentilini gjatë një mitingu legist me të gjitha fyerjet kundër romëve, myslimanëve dhe emigrantëve në përgjithësi, ishte shtytje për racizëm. Për ato fjalë, zëvendës kryebashkiaku i Trevisos është dënuar në fund të tetorit me 4 mijë euro gjobë dhe me ndalimin që të marrë pjesë në mitingje politike për tre vjet.

Edhe pse dënimi është pezulluar me kusht, gjykata e Venecias i ka bërë një dush të ftohtë Gentilinit, duke i njohur vetëm një zbritje të vogël nga kërkesa e palës akuzuese që kërkoi 6.000 euro gjobë, të barabartë me 1 vit e 5 muaj heqje lirie. Sentencë që arrin vetëm një vit pasi mitingu i Legës përfundoi nën lentin zmadhuese të prokurorisë të Venecias.

Ishte 14 shtator 2008 kur, gjatë Festës së Popujve, Gentilini propozoi "një dekalog të kryebashkiakut sherif" të hapur me një apel për "spastrimin e rrugëve nga gjithë këto etni që shkatërrojnë vendin tonë".

Më pas nuk la gjë pa thënë kundër "fëmijëve të arxhinjve që shkojnë e vjedhin të moshuarit", myslimanëve që duhet të shkojnë "të falen në shkretëtirë", kundër napolitanëve që duhet "të hanë plehurat e veta" dhe klientëve të phone-center-ve që "do të bënin mirë të urononin në xhamitë e tyre". Gentilini kërkoi edhe mbështetjen e popullit legist për atë që quajti "revolucion" me objektivin e deklaruar: "Nuk duam më të shohim këta njerëz që shëtisin rrugëve tona".

Sot Gentilini thotë se ka folur hapur, "duke nxjerrë gjoksin e tij ndërkohë që ndonjë është gati t'i qëllojë pas krahëve". Avokati i tij mbrojtës, që ka thënë se do të çojë çështjen në apel shprehet se Gentilini "nuk ia kishte me të keq asnjë race, por shpjegonte idetë e tij të njohura që kanë për qëllim integrimin e etnive të ndryshme". Por për fat jo të gjithë e kuptojnë integrimin si Gentilini.

Elvio Pasca

### PRANGA AGRESORËVE LEGISTË

**Dy jekomunitarë, një shqiptar e një algerian u rrahën keqas në shtator, ditën e festës legiste, në një restorant në qendër të Venecias. Policia ka gjetur katër agresorët falë fanellave të gjelbra që kishin atë ditë. Janë katër legistë nga Bergamo**

Pas një muaji hetime janë gjetur katër militantët legistë nga Bergamo autorë të pandehur të rrahjes së Ervis Docit dhe kolegut të tij algerian, kamerierë në një restorant në qendër të Venecias në shtator, ditën e festës së popujve të organizuar nga Lega.

Gjurma kryesore që ka ndihmuar agjentët Digos të arrinin deri te agresorët kanë qenë fanellat e tyre me viza të bardha e të gjelbra e agresorëve. Duke ndjekur rrugën e atyre fanellave në mijëra fotografe të xhirimeve të festës legiste të 13 shtatorit, hetuesit i kanë hyrë rrugës së mbarë që i ka çuar në Civitate al Piano e Grumello del Monte të Bergamos ku kanë arrestuar 4 militantët legistë. Njëri prej tyre, pikërisht ai që rrahu Ervis Docin, ka precedentë penalë për dhunë. Të gjithë duhet të përgjigjen para drejtësisë për lëndime dhe dëme materiale, me rrethanën rënduese të diskriminimit dhe urrejtjes etnike ose raciale.

Më 30 shtator sanatoria u mbyll. Me paraqitjen e rreth 300 mijë kërkesave, 11 mijë për shqiptarë. Ndërsa ministria e Brendshme bën të ditur që me kuponin që dëshmon paraqitjen e kërkesës së legalizimit, kanë filluar thirrjet e para në Sportelet Unike. Ata që nuk kanë asnjë lajm mund të shohin në faqet internet të ministrisë së Brendshme në ç' pikë është kërkesa e tyre.



mënyrë që të mbarojmë sa më shpejt".

Por si në Romë ashtu edhe në Milano, nuk harrojnë të shtojnë që janë në pritje të personelit të përkohshëm shtesë, në mënyrë që t'u bëhet ballë njëkohësisht edhe punës për flukset dhe bashkimet familjare.

Kush është në pritje të lajmërimit për datën e takimit mund të kontrollojë on-line nëse kërkesa e tij po shqyrtohet akoma nga Kuestura apo nëse i ka arritur Spotelit unik e shpejt do t'i arrijë thirrja për takim. Mund ta bëjë duke u lidhur me sitin e ministrisë së Brendshme

në faqen <http://domanda.nullaostalavoro.interno.it/> dhe të fusë adresën e-mail dhe fjalëkalimin e përdorur fillimisht për nisjen e kërkesës.

Kështu do të zbulojë nëse kërkesa e tij është ende në Kuesturë (në këtë rast do të shohë të shkruar "Richiesta Questura - In attesa del parere della Questura di competenza") apo nëse Kuestura ia ka përcjellë mendimin pozitiv për kërkesën Sportelit Unik dhe ky ka lëshuar datën e takimit (në këtë rast do të gjejë të shkruar "Convocazione Emersione - Viene convocato il datore ed il lavora-

to).

Tani për tani, kontrolli on-line nuk jep informacion për datën dhe orën e takimit, që do të jenë të shënuara në letrën që Sporteli Unik i nis punëdhënësit.

Por këtë kontroll mund ta bëjnë vetëm ata që kanë nisur personalisht kërkesën e legalizimit (që kanë edhe adresën e-mail dhe fjalëkalimin e nisjes), ndërsa ata që kanë kërkuar ndihmën shoqatave apo patronateve duhet t'u drejtohen po atyre për të mësuar në ç' pikë është kërkesa e tyre.

Ndërkaq, ministria e Brend-

shme bën të ditur që kuponin e kërkesës së legalizimit nuk është i vlefshëm për të udhëtuar jashtë Italisë. Klush ka kërkuar të marrë dokumentin e qëndrimit përmes senatores, ka sqaruar ministria nuk mund të trajtohet njësoj si i huaji që ka ardhur në Itali rregullisht dhe është në pritje të lejes së qëndrimit, apo të atij që është në pritje të përtëritjes së dokumentit të qëndrimit. Prandaj kuponin e paraqitjes së kërkesës për përtëritje apo lëshim të lejes është i vlefshëm për të dalë e për t'u kthyer në Itali, ndërsa kuponin që dëshmon paraqitjen e kërkesës për senatore, nuk mund të jetë i vlefshëm për të udhëtuar jashtë Italisë.

Kuponi i senatores mbetet i vlefshëm për familjet e bashkëpunëtorët familjare vetëm brenda për brenda Italisë, pasi duke e treguar atë u shmangen sanksioneve të normave kundër klandestinëve dhe punësimit në të zezë. Nëse thirrjet e Sporteleve Unike do të jenë të shpejta, kufizimi do të ndikojë relativisht pak në jetën e emigrantëve, por nëse përgjigjja e legalizimit do të vonojë me muaj të tërë, kufizimi do të fillojë të rëndojë jo pak.

Sanatoria e fundit ka shpëtuar vetëm bashkëpunëtorët shtëpiakë, duke përjashtuar të gjithë emigrantët e tjerë që punojnë pa leje qëndrimi jashtë katër mureve të shtëpive të italianëve.

Qindra mijëra punëtorë, mura-torë e bujq janë akoma klandestinë, rezikojnë përditë sanksionet e përcaktuara me paketën e sigurisë. Po të hasin një kontroll policie, ata marrin automatikisht paditjen për klandestinitet, dhe, në mënyrë të pashmangshme, dëbimin. Ndërsa kush u jep atyre punë rrezikon burgun nga 6 muaj deri në tre vjet dhe një gjobë deri në 5 mijë euro.

"Sanatore për të gjithë" ishte një nga sloganet e manifestimit të madh të 17 tetorit që solli rrugëve të Romës rreth 200 mijë persona, duke kërkuar kështu shtrirjen e sanatores së bashkëpunëtorëve familjarë edhe për të gjithë punonjësit e sektorëve të tjerë. Propozim ky që pjesërisht gjen vend edhe në një projektligj tashmë në dorë të Parlamentit.

Teksti, i paraqitur nga radikalja Emma Bonino, ka mbledhur mbi 50 firma nga deputetët të shumicës e të opozitës dhe parashikon legalizimin për ata që kanë paraqitur kërkesë për flukset 2007 por që nuk kanë arritur të fitonin një kuotë. Ky projektligj i është dorëzuar komi-

sionit të Çështjeve Kushtetuese në fund të korrikut, por deri tani nuk është diskutuar asnjëherë.

"Nuk është shteti ai që duhet të vendosë nëse duhet legalizuar kush ka këtë apo atë profesion - thotë Emma Bonino. - Angazhimi është maksimal që ligji të vihet në kalendar. Nuk do të jetë e lehtë, sepse kjo është periudhë kur nuk fiton arsyeja por tjetër gjë, si përllogaritjet elektorale. Uroj që dy dhomat e Parlamentit t'i hyjnë diskutimit të ligjit".

Rruga e projektligjit është veç në ngjitje. Në fakt, është vështirë që Lega, që iu desh të kapërdijë legalizimin bashkëpunëtorëve shtëpi-ake, të japë pëlqimin e saj për shtrirjen e legalizimit edhe për punonjësit e kategorive të tjera. Edhe liderët e Popullit të Lirive tregohen të mefshtë kur bëhet fjalë për hapje ndaj imigrantëve, sepse tremben mos një gjë e tillë interpretohet nga zgjedhësit e tyre si lëshim i politikave mbi sigurinë.

Ndaj është më shumë e mundur që të kthehem në sis-

temin e vjetër të legalizimeve të maskuara nga flukset e hyrjes. Praktikisht qeveria do të thotë që mund të hyjë në Itali disa qindra mijëra punonjës jokomunitarë, duke bërë sikur nuk e di që nuk hyn thujse asnjë i ri, sepse të gjithë janë tashmë këtu që punojnë në të zezë. Problemi është se një zgjidhje e tillë kërkon shumë

kohë. "Deri në fund të këtij viti është thujse e pamundur të shpallet ndonjë dekret i ri fluksesh. Edhe për vitin 2010, tani për tani, po programohet vetëm fluksi për punonjësit stinorë" tregon një funksionar i ministrisë së Brendshme.

Elvio Pasca

## "Të vihet në rregull kush ka punë"

Në shesh të përjashtuarit nga sanatoria e, ndërsa një propozim për ligj është tashmë në Parlament. Është shumë e mundur që do të duhet të pritet dekreti i ardhshëm i flukseve

### Studio consulenze e servizi

Për informacione lidhur me konvertimin  
e patentave shqiptare,  
mund të kontaktoni studion në:  
konsulenze@hotmail.it  
tel/fax. 06 70450741 cell. 333 6036690



# LEJE QËNDRIMI për të gjithë ata që kanë punë

Në shesh të përjashtuarit nga sanatoria e, ndërsa një propozim për ligj është tashmë në Parlament. Është shumë e mundur që do të duhet të pritet dekreti i ardhshëm i flukseve



**S**anatoria e fundit ka shpëtuar vetëm bashkëpunëtorët shtëpiakë, duke përjashtuar të gjithë emigrantët e tjerë që punojnë pa leje qëndrimi jashtë katër mureve të shtëpive të italianeve.

Qindra mijëra punëtorë, mura-torë e bujq janë akoma klandestinë, rrezikojnë përditë sanksionet e përcaktuara me paketën e sigurisë. Po të hasin një kontroll policie, ata marrin automatikisht paditjen për klandestinitet, dhe, në mënyrë të pashmangshme, dëbimin. Ndërsa kush u jep atyre punë rrezikon burgun nga 6 muaj deri në tre vjet dhe një gjobë deri në 5 mijë euro.

"Sanatore për të gjithë" ishte një nga sloganet e manifestimit të madh të 17 tetorit që solli rrugëve të Romës rreth 200 mijë persona, duke kërkuar kështu shtrirjen e sanatores së bashkëpunëtorëve familjarë edhe për të gjithë punonjësit e sektorëve të tjerë. Propozim ky që pjesërisht gjen vend edhe në një projektligj tashmë në dorë të Parlamentit.

Teksti, i paraqitur nga radikalja Emma Bonino, ka mbledhur mbi 50 firma nga deputetë të shumicës e të opozitës dhe parashikon legalizimin për ata që kanë paraqitur kërkesë për flukset 2007 por që nuk kanë arritur të fitonin një kuotë. Ky projektligj i është dorëzuar komisionit të Çështjeve Kushtetuese në fund të korrikut, por deri tani nuk është diskutuar asnjëherë.

"Nuk është shteti ai që duhet të vendosë nëse duhet legalizuar

## LEJA E QËNDRIMIT NË KOHË REKORD

### Takimet në kuesturë kudo më të shpejta, me përjashtim të Romës dhe Milanos

Kush kërkon përtëritjen apo lëshimin e dokumentit të parë të qëndrimit mëson menjëherë se kur duhet të paraqitet në kuesturë për dhënien e fotografive dhe të shenjave të gishtërinjve.  
Procedura shtrihet në mbare Italinë

**P**ërveçse në Romë, Milano dhe Aquila, tashmë kush kërkon lejen e qëndrimit mund të marrë menjëherë edhe datën e takimit në Kuesturë. Kur i interesuari dorëzon kërkesën e përtëritjes së dokumentit të qëndrimit, operatori i zyrës postare konsulton on-line agjendën e zyrave për të huajt të kuesturave dhe të prenoton datën kur këto mund të presin të huajin për fotot dhe shenjat e gishtërinjve.

Në këtë mënyrë shmangen pritjet e kota dhe keqfunksionime të ndryshme. Ka ndodhur shpesh, në fakt, që kush ka paraqitur kërkesë për përtëritjen e dokumentit të qëndrimit të ketë pritur me muaj thirrjen për në Kuesturë për të dhënë shenjat e gishtërinjve dhe fotografitë. Për të zbuluar më pas që e kishin thirrur e që kish humbur datën e takimit, sepse letra e porositur nuk i kishte mbërritur kurrë apo sepse nuk ia kishin nisur ndonjëherë, thjesht kishin harruar.

Procedura e re e nisur si eksperiment në pranverë në Firence, Siena dhe Viterbo, tashmë është shtrirë në 100 provinca. Ky shërbim ofrohet në të gjitha zyrat postare që kanë "Sportello Amico", që mund të pranojnë kërkesat për lëshimin apo përtëritjen e lejeve të qëndrimit (për të gjetur "Sportelin Mik" më të afërt mund të lidhesh me faqet internet posteitaliane.it).

Për të përpiluar kërkesën e përtëritjes së lejes së qëndrimit kushdo mund t'u drejtohet sporteleve të patronateve dhe të shoqatave të tjera që kanë lidhur marrëveshje me ministrinë e Brendshme. Në këto sportele janë të detyruar të ofrojnë shërbimin e tyre falas, pa pretenduar "kuotën e regjistrimit" në sindikatë apo shoqatë.

kush ka këtë apo atë profesion - thotë Emma Bonino. - Angazhimi është maksimal që ligji të vihet në kalendër. Nuk do të jetë e lehtë, sepse kjo është periudhë kur nuk fiton arsyeja por tjetër gjë, si përllogaritjet elektorale. Uroj që dy dhomat e Parlamentit t'i hyjnë diskutimit të ligjit".

Rruga e projektligjit është veç në ngjitje. Në fakt, është vështirë që Lega, që iu desh të kapërdijë legalizimin bashkëpunëtorëve shtëpiakë, të japë pëlqimin e saj për shtrirjen e legalizimit edhe për punonjësit e kategorive të tjera. Edhe liderët e Popullit të Lirive tregohen të mefshtë kur bëhet fjalë për hapje ndaj imigrantëve, sepse tremben mos një gjë e tillë interpretohet nga zgjedhësit e tyre si lëshim i politikave mbi sigurinë.

Ndaj është më shumë e mundur që të kthehemi në sistemin e vjetër të legalizimeve të maskuara nga flukset e hyrjes. Praktiki kështu qeveria do të thotë që mund të hyjë në Itali disa qindra mijëra punonjës jokomunitarë, duke bërë sikur nuk e di që nuk hyn thujse asnjë i ri, sepse të gjithë janë tashmë këtu që punojnë në të zezë. Problemi është se një zgjidhje e tillë kërkon shumë kohë. "Deri në fund të këtij viti është thujse e pamundur të shpallet ndonjë dekret i ri flukse-sh. Edhe për vitin 2010, tani për tani, po programohet vetëm fluksi për punonjësit stinatorë" tregon një funksionar i ministrisë së Brendshme.

Elvio Pasca

shqiptari i italisë  
l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i  
**Bota shqiptare**  
gazeta e shqiptarëve në itali

BOTIM I / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIA / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 393-9712595

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE Ë ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORE / IN REDAZIONE Ketii Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

**P**ak liri frymëmarrjeje më shumë për ata që nuk po arrijnë të paguajnë kreditë: familjet më në vështirësi mund të mos paguajnë për një vit këstet. Këtë parashikon "plani familjet" i miratuar së fundmi nga komiteti ekzekutiv i ABI-t, shoqata e bankave italiane.

Nga janari 2010, bankat do t'u pezullojnë për 12 muaj pagimin e kësteve të gjithë atyre që kanë humbur vendin e punës apo punonjësve të pavarur që kanë mbyllur biznesin e tyre. E njëjta gjë do të vlejë edhe për ata që përfitojnë nga "Arka e integritetit", apo për familjet të cilave u ka vdekur pjesëtari që siguronte të ardhurat kryesore.

Detajet (për shembull: si mund të kërkohet pezullimi?) ende nuk janë përcaktuar përfundimisht. Sidoqoftë plani është i përgjithshëm, hedh linjat bazë të pezullimit të kësteve, por askush nuk pengon secilën bankë t'u ofrojë klientëve të vetkushte përfitimi edhe më të mira, si

# KREDITË E SHTËPIVE pezullohen këstet për personat në vështirësi

Bankat miratojnë "Planin familjet".  
Ja kush mund të përfitojë duke filluar nga janari 2010

për shembull, një periudhë pezullimi më të gjatë.

Të dhënat e fundit të IS-TAT-it tregojnë se në Itali ka 1,1 milion familje të varfra, dhe sipas përlogaritjeve të para vetëm 110 mijë prej tyre mund të përfitojnë nga pezullimi i kësteve të kredive.

Mes përfituesve të planit për familjet të bankave mund renditen edhe emigrantët, protagonistët e vërtetë të tregut të shitblerjeve të shtëpive të viteve të fundit. Një studim i ABI-t ka nxjerrë në pah edhe faktin që sot 10% e kredive nëshkruhet nga shtetas joital-



ianë, që në Itali nuk kanë shtëpi të trashëguara dhe as kursime të mjaftueshme për të paguar gjithë vlerën me para në dorë.

Në të vërtetë, një pezullim i kësteve të kredive, edhe më i favorshëm, ishte parashikuar nga ligji financiar i firmosur në vitin 2008 nga qeveria e Prodit: në atë rast flitej për ngrirje të kthimit të kredive për plot 18 muaj e jo 12 si tani. por ai ligj mbeti në letër, sepse as qeveria Prodi e as e tanishmja e drejtuar nga Berlusconi nuk shkruan kurrë rregulloret e zbatimit.

EP

## Mirëserdhët

# në shtëpinë tonë.

Dhomë gjumi  
BRUNELLA  
849€



Paguaj me këste të leverdishme.  
Kërkoje financimin në dyqan.

UNIVERSI I KURSIMIT  
www.mercatoneuno.com



**P**as diplomës së përjetësuar brenda kopertinës së trashë, kurorës së dafinës, kostumit gjysëm-shik e shampanjës së derdhur mes shokësh, për gjithë studentët shqiptarë vjen dita e dilemës së madhe, nga e cila do të varet gjithë ç' do të rrjedhë më pas në jetën e tyre. Të vazhdosh të jetosh në Itali, apo të nisësh për kismet në Shqipëri - kjo është çështja. Dhe nuk është një fjalë goje të vendosësh nëse do të vazhdosh të provosh fatin në Italinë e botës së punës, apo të kthehesh në Shqipërinë që nuk është më ajo e dikurshmja, sepse në përgjithësi kalon shumë kohë para se një studenti t'i vijë dita kur i duhet t'i shtrojë këtë pyetje vetes, por edhe sepse si një vend në zhvillim edhe Shqipëria ka atë aftësinë mahnitëse transformimi të pandalshëm, e të shpejtë, që edhe pse nuk po e shpie direkt e në Evropë, po e bën dita-ditës të paparishikueshme e vështirë të interpretueshme. Dita kur studentët shqiptarë pushojnë së qeni studentë dhe u duhet të rëndin për të rrokur një status të ri, është edhe më e vështirë se sa fundi i adoleshencës kur mes një mijë këshillash të rinjtë vendosin çfarë do të studiojnë, ku, si e nga. Një pjesë e mirë e studentëve shqiptarë largohen nga Shqipëria me mendimin se pas studimeve herët apo vonë do të kthehen në Shqipëri. Por me kalimin e kohës, e viteve të gjatë siç ndodh rëndom të jetë studimi në Itali, i stërzgatur e i shndërruar në një vrapim me pengesa për arsye objektive e subjektive, Shqipëria tëhuajtet dhe është vështirë ta imagjinosh përtej asaj Shqipërie të përzhitur nga vapa e gushtit dhe ngeshmëria e miqve të vjetër gjatë kotjeve të përbashkëta kafeneve të atdheut. Ndërsa urat lidhëse që duhej të orientonin studentët në prag diplomimi e të mbledhnin trurin e shpërndarë për ta shpënë në Shqipëri, janë tog-fjalësha gjenialë që ngjishen letrave nëpër zyrat më brilante të Tiranës, ndërsa në Romë e rrethina përtej detiti Shqipërisë nuk i dëgjohet as zëri. Kështu një student i të sapodiplomuar shqiptar i takon të gjendet përballë dy botëve, të dyja të huaja. Por në kohë krizash ekonomike, e dekadencash ekonomike, shoqërore e kulturore si kjo që ka pllakosur Italinë kohëve të fundit, shpesh kthimi në Shqipëri është i detyruar, dhe nuk janë të papër-



# shqiptari

# italiese.com

portali i komunitetit shqiptar në Itali

TANI EDHE ONLINE



fillshëm studentët që kthehen. Në kërkim të një të ardhmeje më të lehtë, më të suksesshme sepse guri peshon më rëndë në vend të vet, apo thjesht për të rekuperuar ca nga jeta private që është shpesh herë më cilësore në Shqipërinë e ngadaltë e tradicionaliste të urbanizimit të vonë e post-industrializmit të pambërritur. Dhe aty fillon emigrimi i dytë edhe pse me kah të kundërt, ku studentëve u takon të përballen me realitetin e hidhur që nuk përputhet me dëshirat dhe objektivat tru-mbledhëse të qeveritarëve oratorë të Tiranës. Sepse asgjë nuk është automatike dhe, gjithçka nis atje ku mbaroi, me diplomën, konvertimin dhe kopshtjen me vulat dy-krenore. Njohja e diplomës, për ironi të gjithë proceseve të Bolonjës, e konventave të tjera ngazëlyese që Shqipëria ka nënshkruar pa ua rrokur dot kuptimin, mund të zgjasë me muaj e madje edhe me vite. Pastaj fillon zhytja në botën e punës shqiptare, mes brrylave, miqve, meritokratëve, çudive, dhe banalitetëve.

E ndërsa studentët edhe kthehen, tru-mbledhësit zyrtarë nuk janë kujtuar t'i monitorojnë, e të trajtojnë pse-të dhe çne-të e fenomenit, për tu treguar më pas edhe të sapodiplomuarve të tjerë që përpëliten mes dy zjarresh se ç'e ardhme i pret nëse rastësisht vendosin të kthehen. Për të eksploruar copëza nga bota e të diplomuarve të kthyer në faqet e gazetës do të sillen eksperiencat e ndryshme të disa ish studentëve të integruar tashmë në botën e punës në Shqipëri.

Marjola Rukaj

INTERVISTA - ERKA POÇARI

## “VËSHTIRËSITË ME DIPLOMËN PAS KTHIMIT? TË PANUMËRTA. POR NUK JAM PEND- UAR QË JAM KTHYER”

**N**ë Itali shkova për tu shkolluar. Mbarova shkollën e mesme në Greqi dhe nuk doja të vazhdoja të studioja akoma në Greqi. Ishte në të vërtetë edhe një dëshirë e prindërve të mij që gjithë kohës e kanë parë Italinë si një qendër të admirueshme, kulture e qytetërimi. Kështu në të vërtetë mund të them se zgjedhja ime nuk ishte plotësisht rationale por e ndikuar nga një sërë bindjesh të hershme. Shkova të studioj në Macerata. Në Itali u ndjeva mirë, jam ndër si në shtëpi, pas një periudhe shumë të vështirë të fillimit. Në të vërtetë asnjëherë nuk kam dashur të jetoj në Itali. Madje mund të them se që kur zbrita nga treni, në Macerata, pas udhëtimit me traget, në një mbrëmje të zyrtë, vetmitar, shumë të dhimbshëm kuptohet e zhgënjyer i thashë vetes se nuk do të jetoja shumë gjatë në Itali. Nuk mendoja as se do të

# STUDENTËT DHE DILEMA E KTHIMIT NË ATDHE

Bota shqiptare ka nisur një rubrikë kushtuar studentëve shqiptarë në Itali, për t'i njohur përtej numrave të ftohtë të statistikave të përvitshme. Për të zbuluar nëpërmjet vetë eksperiencës së gjithsecilit jetën e studentëve shqiptarë në Itali, qëllimet e tyre, marrëdhëniet me Shqipërinë e me Italinë, vështirësitë objektive e subjektive, botën e punës dhe përfytyrimin e të ardhmes. Pa harruar ata që kanë zgjedhur të kthehen në Atldhe pas përfundimit të studimeve. Të vazhdosh të jetosh në Itali, apo të nisesh për kismet në Shqipëri - kjo është çështja. Dhe nuk është një fjalë goje të vendosësh nëse do të vazhdosh të provosh fatin në Italinë e botës së punës, apo të kthehesh në Shqipërinë që nuk është më ajo e dikurshmjia.

kthehesha në Shqipëri. Por mendoja të kthehesha në Greqi. Ka qenë pak zhgënjyese sepse i prisja italianët të ishin më të ngjashëm me shqiptarët. Ndërsa në të vërtetë më dukeshin të ngjashëm por shumë të ashpër dhe të ftohtë, dhe të qenët shqiptar nuk ishte aspak i thjeshtë, ishte një barrierë e vërtetë në marrëdhëniet midis nesh dhe italianëve. Në të vërtetë ishte formuar klani i të huajve që kishin kohezion vetëm mes tyre dhe nuk kishin asnjë marrëdhënie me italianët.

Kam studiuar jurisprudencë dhe përveç vështirësive që mund të kenë të gjithë të tjerët nga pikëpamja shoqërore, kam pasur edhe shumë vështirësi me gjuhën që në fakultetin e juridikut në Itali shndërrohet në një kriter racizmi, pa e tepruar nëse shprehem kështu. Për shembull nuk mund ta harroj kurrë kur bëra një provim dhe profesori u shpreh pa doreza për ne të huajt se ishim analfabetë. Në këto kushte ishte e pamundur të mendoja se mund të jetoja në Itali. Për këtë gjithmonë kam menduar se duhet të merrja diplomën dhe të ikja.

Nuk jam penduar që kam studiuar në Itali. Është sidoqoftë një eksperiencë që më ka rritur e më ka dhënë shumë. Ka qenë një periudhë krejt e veçantë e jetës sime, ku kam qenë shumë e programuar dhe kam njohur një kulturë që edhe pse thonë se është shumë e ngjashme me tonën, për mendimin tim është shumë e ndryshme. Por ndoshta me gjithë veç do t'i kisha kursyer vetes racizmin shumë të theksuar kundër shqiptarëve.

Në rast se dikush do të më



Vështirësitë e kthimit në Shqipëri? Të panumërta. Kam pasur probleme serioze me burokracinë shqiptare. Kërkonin gjëra me të vërtetë absurde, që nga diploma me një mori vulash të noterizuara e të përkthyer, e deri në guidën e studentit, me programin e fakultetit që duhej sipas burokratëve të këtushëm e noterizuar dhe e vërtetëtuuar nga universiteti

kërkonte një këshillë, do ta ftoja të meditonte. Të gjithë duhet të kenë të qartë se universiteti në Itali nuk është një fjalë goje dhe se duhet një punë kolosale, e rregullt, dhe serioze. Nëse një gjimnazist është studioz dhe i motivuar do t'i këshilloja të studionte në Itali. Dikujt që mendon se gjërat kapërcehen me çapënkllëk do t'i sugjeroja të mos e merrte përsipër këtë sfidë.

Në Shqipëri u ktheva sepse e dija që nuk mund të vazhdoja të qëndroja në Itali. E kam pasur ditur gjithmonë. Menjëherë pas mbarimit të studimeve të mia në Itali, shkova në Greqi për të bërë praktikën e avokatisë, dhe më pas u ktheva në Shqipëri. Nuk kisha menduar në të vërtetë se do të kthehesha në Shqipëri, dhe kisha edhe jo pak probleme me gjuhën, por më pas edhe për probleme familjare mu desh të kthehesha.

Profesioni që ushtroj aktualisht përputhet me formimin tim. Edhe pse ndoshta në këtë sektor ku jam e punësuar aktualisht nuk kam shumë mundësi

për karrierë. Sidoqoftë e quaj veten të sodisfaksionuar nga zgjedhja që kam bërë, dhe jeta që bëj në Shqipëri.

Vështirësitë e kthimit në Shqipëri? Të panumërta. Kam pasur probleme serioze me burokracinë shqiptare. Kërkonin gjëra me të vërtetë absurde, që nga diploma me një mori vulash të noterizuara e të përkthyer, e deri në guidën e studentit, me programin e fakultetit që duhej sipas burokratëve të këtushëm e noterizuar dhe e vërtetëtuuar nga universiteti. Kam pasur probleme të panumërta që më kanë detyruar të kthehem disa herë në Itali për t'i legalizuar dhe plotësuar të gjitha kërkesat. Kam pasur shumë sorollatje, dhe për njohjen e diplomës përfundimisht kam kaluar një kalvar 2-vjeçar e madje nga sa kam njohur e kam parë gjatë radhave nëpër zyrat e njohjes së diplomës, ka edhe raste kur për të bërë konvertimin e diplomës u është dashur 3-4 vjet. Është e kotë të thuhet se është një torturë e tepërt.

Ndërsa për sa i përket njohjes së programit, nuk më është dashur tu ushtrohem provimeve të tjera. Kjo ndoshta sepse duke pasur mbaruar juridik, një pjesë e mirë e legjislacionit shqiptar ka si model kodet dhe ligjet italiane, kështu që pavarësisht se formimi im ishte në përputhje me sistemin italian ishte më se i përshtatshëm edhe për Shqipërinë.

Nuk jam penduar që jam kthyer. Po të kthehesha pas në kohë të isha kthyer sërish. Nuk mendoj se do të kisha pasur një të ardhme më të mirë në Itali.

ma.ru.



Albana Temali

Rastësisht, e vetëm para pak muajsh e pashë në foto Artilën pas shumë e shumë vitesh. Nëna e saj, Rudina, me kënaqësinë e krenarinë e kuptueshme prej prindi, pasi arritjet e fëmijëve i japin kuptim jetës e justifikim sakrificave në mërgim ma tregoi në albumin që mbante me vete, atë ditë shtatori në Shkodër. Artila mes motrave të saj Artemisa e Giovanna (që ka lindur në Itali) më përcolli jo vetëm çiltërsinë e moshës por edhe më dha përshypjen e një vajzë "in gamba". Mësova që studion në Fakultetin e Ekonomisë Aziendale në Novara, qytet ku prej vitesh është vendosur familja e saj, por dhe që aktivizohet në grupet sociale ku kërkohet ndihma për procesin e integritimit të emigrantëve që arrijnë në këtë zonë. "Artila një studente shqiptare si shumë të tjerë" - ky ishte dhe komenti i thjeshtë e modest i nënës së saj atë ditë.

Por një artikull i datës 10 tetor 2009 publikuar te gazeta italiane "La Stampa" - Novara Citta' i shkruar nga Barbara Cattovaz me njohu më në detaj me aktivizimin e Artilës në sociale. Ajo, që bashkë me studentë të tjerë kishte zgjedhur të ndjekë projektin e komunitetit evropian "Futur lab" propozuar nga Universiteti ku studion dhe prej disa muajsh, për 6 orë në ditë, për një totale prej 30 orë në javë kalon nga njëra shkollë fillore te tjetra për t'u mësuar fëmijëve emigrantë, që sapo kanë mbërritur në Itali gjuhën italiane.

"Te këta fëmijë shoh veten time para gjashtë vitesh - thotë Artila. Sot jam unë që i ndihmoj të mësojnë gjuhën me të cilën do të komunikojnë në kopsht e më pas në shkollë. Për momentin ndjek një vajzë gjashtëvjeçare që sapo ka mbërritur nga Bangladeshi. Quket Shomaja dhe komunikimi aq sa elementar për vetë moshën e saj, është po aq i vështirë mbasi ajo nuk e njeh gjuhën tonë e nuk njohim asnjë gjuhë tjetër të përbashkët që

**La storia**  
BARBARA CATTIVAZZE  
Nella scuola più multietnica della città

**“Aiuto i bambini immigrati In loro rivedo me stessa”**  
Studentessa albanese insegna italiano agli scolari di Sant'Agabio

**Salvatore Palvetti**  
Dirigente delle scuole di S. Agabio «Porteremo in classe le mamme»

**Nadia Lardinessi**  
L'insegnante responsabile dei bambini stranieri alla scuola Don Pozzetto

**Artila Kovaci**  
Studentessa di origine albanese oggi aiuta i bambini stranieri a integrarsi a scuola

**RECORD**  
In prima IS iscritti su 25 sono extracomunitari ma molti bimbi sono nati qui

**MAGGIORANZA**  
Nelle elementari Rignini e Don Pozzetto gli stranieri spesso superano i novaresi

**RECORD**  
In prima IS iscritti su 25 sono extracomunitari ma molti bimbi sono nati qui

**RECORD**  
In prima IS iscritti su 25 sono extracomunitari ma molti bimbi sono nati qui

# STUDENTJA ARTILA KOVAÇI aktiviste e zellshme sociale

Artila kalon nga njëra shkollë fillore te tjetra për t'u mësuar fëmijëve emigrantë, që sapo kanë mbërritur në Itali gjuhën italiane. "Te këta fëmijë shoh veten time para gjashtë vitesh" thotë Artila.



të shpjegohet e mësohet italishtja, apo thjesht të niset komunikimi. Problemet janë të shumta, por jo të paarritshme. Te vogëlushja shikoj e ndjej dëshirën për të mësuar, dhe kemi hedhur ngadalë dhe nga një punë sistematike e përditshme".

Në zonën e Novarës ka shumë fëmijë të huaj në shkollë dhe mosnjohja e gjuhës ndikon te të ecuria në përvetësimin e dijeve e si rrjedhojë në procesin e integritimit të tyre.

"Edhe unë kam arritur në Itali vetëm 6vjeç, shton Artila, por isha me fat mbasi në Shqipëri kisha mësuar fjalë e shprehje, që më ndihmuan shumë të mos ndihesha e izoluar me bashkëmohatarët dhe të përparoja në mësim. Sot studioj në Universitet".

Projekti "Futur-lab" vazhdon një vit dhe impenjimi është total, aq sa Artila me shoqet e saj studente të përfshira në këtë projekt kanë të llogaritur e organizuar mirë

çdo orë të ditës. Studimi për provimet është zhvendosur në orët e vona të natës apo herët në mëngjes dhe ndihmohen nga shënimet përmblendhëse që u bëjnë në leksione shoqet e kursit. Muajin dhjetor vjen sezoni i provime; sezoni nuk duhet humbur e për këtë arsye projekti duhet të marrë masa për të mbuluar mungesën për disa ditë të Artilës. Nuk dua të harroj që përveç punës me vogëlushët, Artila luan edhe rolin e ndërmjetësueses në kurse të italishtes që organizohen për gratë emigrante, edhe ato në pozita pothuaj të njëjta me fëmijët e sapombërritur.

Ky projekt evropian po ecën mbarë në zonën e Novarës, falë impenjimit të organeve lokale, por edhe të operatorëve që zbatojnë objektivat me ndërgjegje e impenjim. Si Artila, studentja shqiptare si shumë të tjerë me të cilët, pse jo, krenohemi ne bashkatdhetarët e saj në Itali.



Vetëm **15 cent.€/min**  
për të telefonuar në **Shqipëri.**  
Atdheu yt nuk ka qenë kurrë  
**kaq afër.**



Aktivizo menjëherë No Distance  
dhe telefono në Shqipëri me 15 cent.€/min.



 Store | [www.tre.it](http://www.tre.it)

199 100 700

SHKREHJA E PËRGJIGJES 16 CENT.€, TARIFIMI VETËM MBI SEKONDAT EFEKTIVE TË BISEDËS. OPSIONI NO DISTANCE AKTIVIZOHET ME 0€ PËR 30 DITË E PARA NËSE NËNSHKRUHET GJATË FAZËS SË AKTIVIZIMIT TË NJË SKEDË RIMBUSHËSE 3. NË SKADIM PARASHIKOHET PËRTERITJA AUTOMATIKE PËR 30 DITË KUNDREJT KOSTOS SË 5€. OPSIONI I VLEFSHËM VETËM NË ITALI NËN MBULIMIN KOMBËTAR TË 3, PËR PERIUdhËN E AKTIVIZIMIT, DHE JO I PAJTUESHËM ME PLANIN RIMBUSHËS SUPER O MONDO, ME OPSIONIN INTERNATIONAL 3 DHE ME PLANET E ABONIMIT. PËR INFORMACIONE MBI MBULIMIN, KUSHTET DHE KOSTOT [WWW.TRE.IT](http://WWW.TRE.IT) OSE 3 STORE.



## HELIDON XHIXHA NJË ÇMIM KARRIERE NË NOVARA

Më 10 tetor 2009, Bashkia e qytetit Novara i ka akorduar skulptorit shqiptar Helidon Xhixha dhe piktorit italian Enrico Colombotto "Çmim për Karrierë". Ceremonia e dhënies së çmimit u organizua në Salone Arengo del Broletto, në praninë e përfaqësuesve të autoriteteve lokale, kritikeve, galeristëve, gazetarëve e dashamirësve të artit e miq të artistit e bashkëpunëtorë të tij.

Kjo ceremoni ishte planifikuar dhe u realizua në ditën e inaugurimit të Edicionit të 9-të të Ekspozitës kombëtare për Pikturë e Skulpturë në Novara, një aktivitet ky që konsiderohet si një nga vitrinat më të rëndësishme të ofertës kulturore novareze dhe përbën një moment për t'u "takuar" me qytetin e Novarës dhe pasurinë e tij artistike e kulturore.

Skulptori nga Durrësi, Helidon Xhixha, i adoptuar nga Novara, arriti te ky çmim falë studimit, punës krijuese e kërkuese dhe nivelit të lakmueshëm bashkëkohor të arritur, por në të njëjtën kohë edhe falë aftësisë e shkallës së integritetit në jetën sociale e kulturore të vendit ku ka vendosur të ndërtojë të ardhmen e tij si artist e si qytetar. Novara, ku artisti jeton e punon prej vitesh mban në sheshet e saj skulpturat e tij. Bashkia e qytetit i ka dedikuar një hapësirë të veçantë ekspozimi në një nga parqet më të frekuentuara nga qytetarët. Skulptura të tjera monumentale apo basorelieve të punuara në çelik të paoksiduar ndodhen "me qëndrim të përhershëm" në sheshin "El Alamein", në sheshin para Bashkisë apo para Kuesturës Novara. Por, skulpturat e Helidonit i gjen edhe në rajone të tjera të Italisë, në Emilia Romagna, në Maranello, ku tashmë të gjithë e njohin "Kalin Kas" që ndodhet para Stabilimentit Ferrari (afër autodromit të garave të F1-shit) i cili dominon sheshin me 6 metrat e gjysmë të tij, apo skulptura të tjera monumentale në Stressa, në Palazzola e në LungoMare.

Gjithnjë në kërkim të rrugëve të reja shprehëse, kohët e fundit ka realizuar serinë e punimeve "Energjia nëpërmjet ngjyrës", e cila tërhoqi vëmendjen e kritikës e galeristëve në ekspozimet ndërkombëtare të artit bashkëkohor si ajo e MIART dhe ARTVERONA.


Në fazë përfundimi është edhe projekti i nisur vite më parë për vendosjen e skulpturës monumentale "Rilindja e Kullave" në Nju Jork, pas itinerarit ekspozues në disa qytete në Europë si në Firenze, Milano, Stressa, Como, Berlin.

Të njëpasnjëshme dhe ofertat për ekspozim, ndër më të fundit në ditën e inaugurimit të stinës së 9-të Simfonike 2009/2010 dhe të projektit "from Columbus to Columbus" në Sallën Verdi të Konservatorit të Milanos, më 14 Tetor 2009, ndërkohë që sapo ka dalë nga shtypi katalogu zyrtar i artistit shqiptar, me botues Skira - një pasqyrë e plotë e krijimtarisë artistike të Xhixha e ku fjala e kritikës është ajo që përcakton të ardhmen e krijuesit e mbetet gjithnjë pikë referimi për specialitet të artit.

Albana Temali

## DRIANT ZENELI

### Një shqiptar fitues i konkursit fotografik Trieste Contemporanea



**E**ka fituar një shqiptar këtë vit konkursin Trieste Contemporanea, një event dhe një mundësi e ndërnuar në qytetin e Adritikut verior pikërisht për të gjetur e stimuluar artistët e rinj që kanë bërë të tyrin si mjet shprehës artin bashkëkohor dhe shumëllojshmërinë e stilistikës konceptuale e figurative që ai lejon. Dhe këtë vit artisti i ri që juria ka vendosur të përkrahë e të promovojë në skenën e të talentuarve të arteve të reja figurative, ka qenë Driant Zeneli. Është një artist i ri por, me një eksperiencë të gjatë e me një kurrikulum të dendur me ekspozitë. I lindur në Shkodër dhe me banim në Itali, ai është i pranishëm edhe në Shqipëri në shumë nga aktivitetet më të bujshme e më cilësore të artit bashkëkohor shqiptar, si për shembull Onufri i para pak viteve. Edhe pse shumë i ri në moshë spikat tek ai një vetëdije tejet kritike që arrin të transmetojë shumë për marrësin e veprave të tij. Në qendër të asaj që ka ngacmuar njeshmërinë e tij intelektuale përgjithësisht duket të jetë Shqipëria në pikëpamjen e saj kritike të zhvillimit të tanishëm dhe të së kaluarës. Kështu komentojnë kritikët e konkursit të Triestes që kanë vlerësuar artistin shqiptar për aftësinë e të shprehurit me mjetet multimediale të koncepteve të plota që burojnë nga disa përmasa të vendit prej nga vjen. Kufiri i hollë mes realitetit dhe utopisë është ajo që i intereson 25-vjeçarit shqiptar veçanërisht dhe që ai shpreh nëpërmjet videos dhe fotografisë, ndërsa përmbajtja është e larmishme, që nga gjetja për të shprehur koncepte nëpërmjet një interviste marrë të atit, deri tek kombinimi i lehtësisë së dritave të neonit për të dhënë njësinë e brishtësisë së të tashmes dhe të perceptimit të pakapshëm të momentit.





# Në Centro Documentazione Città di Arezzo lexon edhe shqip

Nga fillimi i viteve 90, me rritjen e fluksit të emigracionit, vëmendja e Qendrës u përqendrua mbi temat e mikpritjes së emigrantëve, shkollimit të fëmijëve të tyre, dhe edukimit ndërkulturor. Aktualisht ka një bibliotekë publike të përbërë prej 17 mijë volumesh me më shumë se 3.500 në gjuhët shqip, arabisht, bangla dhe punjabi.

Në Itali ka shumë qendra interkulturore që merren me temat që kanë të bëjnë me emigracionin, të drejtat e njeriut, zhvillimin e kulturës së paqes, dhe argumente të ngjashme. Në këtë seri artikujsh do të flasim me disa prej tyre që janë dhe më përfaqësueset për nga bagazhi i eksperiencës që përcjellin. Arsyeja tjetër është se në shumicën dërmuese të rasteve, janë pikërisht këto qendra që garantojnë praninë e librave shqip në qytetin ku jetoni e punoni në Itali.

Këtë muaj ju paraqesim Centro Documentazione Città di Arezzo, një eksperiencë më shumë se 20 vjeçare në Arezzo, qytet i krahinës së Toscana -s. Këtë intervistë na e ka lëshuar Lorenzo Luatti, kërkimtar i kësaj qendre dhe autor i shumë librave që kanë të bëjnë me interkulturën.

**Zoti Luatti, në radhë të parë doja tu falënderoja që na dhatë mundësinë e kësaj bisede dhe do më pëlqente të më flisnit pak për historinë e Qendrës. Prej sa kohësh ekziston dhe me çfarë merit kryesisht?**

Faleminderit juve që nëpërmjet gazetës suaj na jepni mundësinë të pasqyrojmë shqiptarëve në Itali aktivitetet tona. Centro di Documentazione Città di Arezzo lind para 25 vitesh, në 1984, nga nisma e disa shoqatave me seli në Arezzo. Fillimisht u mendua si një ambient ku të mblidheshin librat, revistat dhe material dokumentar që kishte të bënte me paqen, të drejtat e njeriut, tematikat e vendeve në zhvillim e sipër etj. Nga fillimi i viteve 90, me rritjen e fluksit të emigracionit, lindën nevoja të reja të lidhura me këtë dhe vëmendja jonë u përqendrua mbi temat e mikpritjes së

emigrantëve, shkollimit të fëmijëve të tyre, dhe edukimit ndërkulturor. Rreth këtyre tematikave, prej më shumë se 10 vitesh tani, Qendra është shndërruar në pikë referimi jo vetëm për krahinën ku jetojmë, por në nivel kombëtar. Aktualisht kemi një bibliotekë publike të përbërë prej 17 mijë volumesh me më shumë se 3.500 volume në gjuhët shqip, arabisht, bangla dhe punjabi.

**Kur keni filluar të merreni me bibliotekat të pajisura me libra në gjuhë të ndryshme dhe çfarë ju ka shtyrë në këtë drejtim?**

Në vitin 2003, falë projektit "Bibliomigrans", lind biblioteka e parë shumëgjuhëshe në Arezzo. Ka qenë një zhvillim i aktiviteteve tona. E konsideronim si shumë të rëndësishëm faktin e të dhënit të disa mundësive kulturore më shumë emigrantëve. Në specifik, një nga këto mundësi kulturore ishte dhe fakti që një emigrant të mund të gjejë në bibliotekën e qytetit ku jeton një libër në gjuhën e tij. Në projektin e lartpërmendur janë angazhuar 5 biblioteka publike të provincës së Arezzo-s, me të cilat kemi eksperimentuar një shërbim të "një rafti lëvizës"; në mënyrë periodike Qendra u ka dërguar këtyre bibliotekave 40 - 50 libra në gjuhë të ndryshme, duke bërë të mundur që librat të arrinin dhe në vende të vogla.

**Këto nisma kanë pasur sukses ndërmjet popullsisë së huaj që banon këtu?**

Në fillim na u duk sikur të gjitha përpjekjet tona po venin dëm. Kishim libra për të rritur, për fëmijë, të të gjitha llojeve. Nuk ishte e lehtë të depërtonim për të treguar pasurinë e librave që dispononim. Sot gjërat


venë më mirë, falë dhe krijimit të një strukture që quhet "Polo Regionale di Documentazione Interculturale".

Kemi pasur sukses dhe duke nxjerrë librat nga bibliotekat dhe duke i çuar nëpër vende që zakonisht frekuentohen nga të huajt. Mund të themi se sot kemi një fluks të kënaqshëm të huajsh që vijnë në bibliotekë, ndër ta shumë shqiptarë.

**Cilat janë pikat që duhen përforcuar në këtë lloj shërbimi sipas jush?**

Ka me siguri akoma shumë për të bërë, që të njihen sa më shumë me shërbimin e librave në gjuhë të huaj dhe promovimin e bibliotekës si vend takimi. Ndoshta duhet të punojmë më shumë me angazhimin e komuniteteve të huaja në fazën e projektimit dhe administrimit të këtyre shërbimeve; duhet një raport i barabartë ku të gjithë të jenë protagonistë dhe jo vetëm spektatorë. Një tjetër aspekt që duhet përforcuar është komunikimi, edhe pse nuk është i mjaftueshëm. Mendojmë se një gjë shumë efektive do të ishte organizimi i takimeve kulturore të komuniteteve të huaja në ambientet e bibliotekës. Kjo me siguri do ndihmonte për një njohje reciproke sa më të mirë.

**Çfarë këshille do mund t'i jepnit një shqiptari që jeton në Itali përta i përket mundësisë që të ketë në dispozicion libra në gjuhën mëmë? Mund ti kërkojë në bibliotekën komunale të vendit ku jeton?**



Tashmë gjithnjë e më shumë biblioteka janë të pajisur me libra shqip, edhe pse në shumë raste me një numër të kufizuar. Shpesh herë në fakt shumë biblioteka i janë përgjigjur në mënyrë amatoriale nevojave të shprehura nga të huajt, duke mos pasur shumë kujdes në përzgjedhjen e titujve. Këshilla që unë jap është që të drejtohen te biblioteka komunale më e afërt dhe të kërkojnë librin shqip. Do të shihni që edhe nëse biblioteka nuk ka të tillë, do të bëjnë të pamundur që të kënaqin kërkesat tuaja. Nëse banoni në Toscana është disi më e thjeshtë, pasi biblioteka mund të drejtohet Polo Regionale Interculturale, që mund të pajisi bibliotekën me librat e kërkuar. Pra me pak fjalë, nëse bibliotekat shikojnë që ka interes për të lexuar librin shqip, me siguri do pajisen me këtë lloj libri.

**Zoti Luatti ju urojmë punë të mbarë dhe ju falënderojmë sërish për intervistën.**

Faleminderit gazetës suaj që na jep mundësinë të flasim me komunitetin shqiptar.

Centro di Documentazione Città di Arezzo

www.cddarezzo.org  
info@cddarezzo.org  
Via Masaccio, 6/A  
52100 Arezzo  
Tel. 0575.902488



PROMOZIONE E DISTRIBUZIONE DEL LIBRO ALBANESE IN ITALIA

[www.librialbanesi.it](http://www.librialbanesi.it)

Për çfarëdolloj informacioni, kërkese, opinioni dhe bashkëpunimi që ka të bëjë me librin shqip, mos hezitoni të na kontaktoni

[info@librialbanesi.it](mailto:info@librialbanesi.it) Tel: +39 3890939930 Fax: 0575 1949538

# POWERCARD

## Leverdis sepse flet më gjatë!

MINUTA SHQIPËRI € 10	NGA NUMËR FIKS	NGA NUMËR PUBLIK	NGA CELULAR ITALIE	NGA CELULAR WIND	NGA NUMËR GJEOGRAFIK
SHQIPËRI	180	64	38	70	200
SHQIPËRI, TIRANË	300	82	44	86	320
SHQIPËRI, CELULARË VODAFONE	54	36	26	36	60

Zbulo  
leverdinë Powercard  
për vendin tënd në  
[www.powercard.it](http://www.powercard.it)  
ose pranë pikave Sisal

SINERGIA ADV.

**tag**  
KEEP IN TOUCH

Tarifa në fuqi nga 01/09/09 për kartat e  
parapaguara prej 10 eurosh, lista tarifore  
Powercard ShBA&Europa e TAG International.  
Tarifat shpallen në faqet internet [www.powercard.it](http://www.powercard.it)

Informacione në 06 96595959

**POWERCARD ËSHTË NË SHITJE  
NË TË GJITHA PIKAT SISAL.**







# OLEN CESARI

## “Të nxisim kulturën tonë”

**P**aganini i ri, e quajnë ekspertët e violinës. Dhe virtuozi i violinës së tij u mbërrin mjeshhtërisht edhe më profanëve. Olen Cesari është violinisti gjenial që ka shpënë emrin e Shqipërisë në skenat më prestigjioze të muzikës klasike dhe në çmimet më të lakmuara të muzikës botërore. I lindur në Durrës nga një familje artistësh Cesari ka mahnitur Shqipërinë duke filluar debutimin e tij në moshën 5 vjeçare, ndërsa kurorëzimet e suksesit erdhën njëra pas tjetres në kohë rekord me çmimin më të lartë të muzikës klasike në Shqipëri, e më pas një bursë studimi në konservatorin e Romës Santa Cecilia. Rekordet vazhduan të karakterizojnë karrierën e tij prej të riu fenomenal e madje në moshën 17-vjeçare Cesari përfundoi

konservatorin e Santa Cecílias me notën maksimale duke u bërë kështu i diplomuari më i ri në moshë në historinë e shkollës prestigjioze të muzikës. Më pas kërkimi muzikor e ka çuar edhe më lart e në shtigje të reja muzikore duke e shndërruar Paganinin e ri në një muzikant eklektik që lëviz lirshëm mes muzikës kasike, jazz-it, pop-it e muzikës tradicionale të botës. Ndërsa në Itali, vendi ku jeton ndërmjet koncerteve të panumërta, është i famshëm jo vetëm për artdashësit më të rafinuar që i njohin ri-aranzhimet e kolosëve klasikë të violinës apo ekzekutimet e tij që i vlejten emrin Paganini i ri, por edhe për bashkëpunimet e suksesshme me këngëtarë si Daniele Silvestri, Max Gazzé, apo Carmen Consoli. Ndërsa shpesh herë ka debutuar me

**Violinisti gjenial që prej vitësh luan krah artistëve më të mëdhenj italianë, i mëshon rëndësisë që merr promovimi kulturës sonë në Itali nga ana e artistëve që jetojnë e punojnë këtu.**

emrat më të njohur të muzikës së lehtë italiane në skenën e San Remos.

Ndërsa është pa dyshim një artist me një jetë kozmopolite, po aq sa edhe profil eklektik, në të ardhmen e afërt gjeniu i violinës parashikon t'i rikthehet Shqipërisë, jo skenës shqiptare, ose të paktën jo intensivisht por kulturës shqiptare dhe pasurisë së larmishme të muzikës tradicionale, që mund të shërbejë si lëndë e parë transformimesh dhe aranzhimesh kreative. "Sepse ka ardhur koha të promovojmë kulturën shqiptare, e të tregojmë vërtetë se kush jemi" thotë Cesari duke lënë të hamendësohet përmbajtja e albumit të tij të ardhshëm.

(vijon intervista)

# OLEN CESARI



## INTERVISTA

nga Marjola Rukaj

**Shqiptari i Italisë:** Përse vendosët të transferoheshit pikërisht në Itali?

**Olen Cesari:** Në kohën e komunizmit në Shqipëri nuk kishe mundësi të vazhdoje studimet në konservatorët e botës por unë isha vetëm 13 vjeç dhe kisha mbaruar institutin e lartë të arteve në Tiranë si rast i jashtëzakonshëm kështu që më në fund pas shumë e shumë sakrificash më dhanë një bursë studimesh për në Itali. Në moshën 14-vjeçare erdha në Romë i shoqëruar nga mamaja ime të vazhdoja studimet në konservatorin e Santa Cecilia. E pranova bursën për në Itali edhe sepse kërkesa fillestare ishte për konservatorin e Parisit por përgjigjja m'u dha o kështu o hiç fare

**Duke bërë një bilanc çfarë mundësish ju ka dhënë formi-**



”  
Ka nja dy vjet që ka shumë Shqipëri në jetën time. Më përpara kishte shumë pak, gati aspak madje do të thosha. Më parë bëhej fjalë vetëm për një marrëdhënie profesionale dhe asgjë më shumë se kaq. Shkoja në Shqipëri vetëm për koncerte dhe kthehesha ditën tjetër, të nesërmen e koncertit koncerti.

**mi në Itali?**

Italia ka një kulturë muzikore mijërvjeçare, ka në traditën e saj fillimet e muzikës. Pastaj natyrisht ka brenda territorit të vet, Vatikanin shtetin që ka investuar në art e kulturë e muzikë gjatë gjithë kohës së ekzistencës së tij. Për më tepër Roma ka një konservator mbi 400-vjeçar dhe bilanci që unë i bëj vetes nuk mund të mos jetë më se pozitiv

Edhe sepse isha emigrant këtu, Italia mi hapi portat e saj nëpër të gjitha skenat duke filluar nga skenat e konkurseve kombëtare e ndërkombëtare, duke më bërë solist me vite të tëra në RAI, radio televizioni italian, në programet më të rëndësishme artistike të udhëhequra nga Pippo Baudo deri tek skena me 2 milion spektatorë në rastin e koncerti për nder të Papës Gjon Pali II në Bolonja.

**Sa Shqipëri ka në jetën tuaj sot?**

Ka nja dy vjet që ka shumë Shqipëri në jetën time. Më



përpara kishte shumë pak, gati aspak madje do të thosha. Më parë bëhej fjalë vetëm për një marrëdhënie profesionale dhe asgjë më shumë se kaq. Shkoja në Shqipëri vetëm për koncerte dhe kthehesha ditën tjetër, të nesërmen e koncertit koncerti. Por të rrimë shtrembër e të flasim drejt, Shqipëria ka ndryshuar edhe po ndryshon ditë për ditë e më shumë.

#### Jeni i pranishëm në skenat shqiptare?

Do të më pëlqente të ekzekutoja më shpesh por ftesat për koncerte më vijnë nga gjithë bota por jo nga Shqipëria dhe nuk e kuptoj përse. Po kërkoj të gjej një strukturë organizative që realizon koncerte në Shqipëri të them të vërtetën. Këtë e synoj sepse do të doja të dilja nga ajo rutina e Pallatit të Kongreseve apo edhe e Teatrit të Operës dhe Baletit. Natyrisht jam i mendimit se muzika i përket të gjithë popullit dhe jo vetëm elitës. Jo të gjithë mund të vijnë në këto struktura dhe të paguajnë biletat për shembull, sa për të përmendur vetëm një prej kufizimeve që sjell ky monopolizim i kulturës nga këto institucione. Për më tepër unë parapëlqej, e prirrem natyrshëm të lëviz nëpër të gjitha gjinitë e muzikës kështu që do më pëlqente shumë të organizoja koncerte nëpër sheshet e qyteteve në Shqipëri ose nëpër vendet arkeologjike me grupin tim.

#### E ndiqni pak a shumë artin shqiptar? Ç'mendim keni për të?

Që kur kam vënë Digitalb-in në shtëpi jam i lidhur më shumë me artin shqiptar. Dhe mendoj që shteti shqiptar duhet të investojë më tepër për artin. Edhe ne artistët shqiptarë duhet të marrim përsipër një funksion ndërkombëtar e kulturor, për t'i hapur një dritare botës së huaj mbi Shqipërinë. Nuk po flas vetëm për muzikën. Për shembull një aspekt po aq i rëndësishëm do të ishte të promovoheshin filmat shqiptarë. E kam fjalën për manifestime nëpër vendet e botës të organizuara nga ambasadat shqiptare me artistë shqiptarë dhe me temën "Shqipëria". Jam i bindur se kjo do t'i bënte shumë mirë Shqipërisë. Kërkoj ndjesë nëse e teproj me këtë lloj këmbënguljeje, por kemi vuajtur shumë gjithë këto vite për të mbrojtur dinjitetin e



këtij kombi..

Dhe tani sipas mendimit tim tani ka ardhur momenti të promovojmë Shqipërinë nëpër gjithë botën.

#### Bën pjesë disi Shqipëria në projektet tuaja?

Bën pjesë patjetër, e madje pa diskutim. Tirana është

vetëm një orë fluturimi larg nga Roma, pra është njësoj sa Romë- Milano! Kam shumë miq italianë që po fillojnë të mendojnë të vijnë dhe të vizitojnë por edhe të kalojnë pushimet në Shqipëri.

#### Si ka ardhur eklektizmi juaj artistik?

Edhe ne artistët shqiptarë duhet të marrim përsipër një funksion ndërkombëtar e kulturor, për t'i hapur një dritare botës së huaj mbi Shqipërinë. Nuk po flas vetëm për muzikën. Për shembull një aspekt po aq i rëndësishëm do të ishte të promovoheshin filmat shqiptarë. E kam fjalën për manifestime nëpër vendet e botës të organizuara nga ambasadat shqiptare me artistë shqiptarë dhe me temën "Shqipëria".

Mbasi mbarova konservatorin në Romë shkova të bëja një konservator tjetër në Austri. Pasi mbarova edhe këtë shkova në Amerikë dhe atje m'u hapën horizontet krejtësisht të tjera. Kuptova thellësisht faktin që nuk ekziston vetëm muzika klasike por të

vijon në faqen 16





## OLEN CESARI



vijon nga faqja 15

gjitha llojet e muzikave botërore të japin njohuri dhe pasuri dhe muzikanti duhet t'i njohë të gjitha zhanret .

**Cilin zhanër preferoni më shumë?**

Zhanret janë të ndryshme. Do të përmendja Pop, Hip pop, jazz, R&B. Në të vërtetë nuk jam në gjendje të vendos një zhanër sepse më duket se secili prej tyre ka diçka të mrekullueshme brenda. Mirëpo në gjithë këtë mori zhanresh nuk ka diskutim se baza sidoqoftë është muzika klasike të cilën unë e vendos në vendin e parë. Dua të them me këtë se pa një njohuri të thellë të muzikës klasike nuk është e mundur të notosh në oqeanin e thellë të muzikës botërore.

**Ju keni punuar edhe me grupet që lëvronin muzikë etnike si Meridia apo më vonë Ogila. Çfarë e shtyn një violinist të merret me muzikë të këtij lloji?**

Meridia ishte një grup muzike popullore italiane dhe

”

**Muzika shqiptare popullore është një perlë, është një thesar, por nuk ka vitrinën e duhur për momentin. Ka ardhur koha t'i kallëzojmë botës kush jemi me të vërtetë**

trajtonte muzikën nga 1400 deri në ditët e sotme. Merreshin kryesisht me valle tarantele këngë napolitane e shumë të tjera të këtij lloji. Kurse grupi Ogila ishte një grup që merrej me muzikë cigane ruse, hungareze, sllave në përgjithësi edhe ishte një eksperiment social, sepse ishim të gjithë nga Ballkani. Kjo ishte e veçanta dhe e bukura e grupit por që solli edhe shpërbërjen e tij. Pikërisht kur filloi lufta në Kosovë grupi u prish. Gjithsesi kurioziteti për të njohur të gjitha zhanret do të ishte

përgjigjja ime më e saktë për gjithë këtë eksplorim që më vjen natyrshëm si prirje gjatë marrjes sime me muzikë viteve të fundit.

**Ka disa artistë që riorkestronjë e përpunonjë muzikën tradicionale shqiptare duke ia ofruar atë një publiku ndërkombëtar. Ju jeni i tunduar nga një mundësi e tillë? Si e vlerësoni në këtë prizëm muzikën tradicionale shqiptare?**

Pikërisht në këtë periudhë jam duke punuar për realizimin e një albumi të ri me muzikë nga bota. Dhe jam i bindur se në këtë album do të ketë dy këngë popullore shqiptare të riarranzhuara. Edhe për këtë aspekt mendoj dhe citoj sërish atë që thashë më parë. Muzika shqiptare popullore është një perlë, është një thesar, por nuk ka vitrinën e duhur për momentin. Ka ardhur koha t'i kallëzojmë botës kush jemi me të vërtetë dhe nga vijnë me të vërtetë. Këtë mund ta bëjmë shumë mirë nëpërmjet kulturës sonë. Bota është me rrota!!!







**MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.**

## **Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.**

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizim falas për të gjithë klientët e rinj deri më 7 shkurt 2010

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione [www.wind.it](http://www.wind.it)



**WIND**

*abonohu në*

# Bota shqiptare

GAZETA E SHOIPTARËVE NË ITALI

fituese e çmimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetri zë në gjuhën shqipe në shtypin italian

"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali

"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar.

"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëmsajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

**PAJTOHU PËR VETE**  
*apo për t'ia bërë dhuratë një miku*

abonimi për një vit (22 numra)

**€ 35.00**

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT  
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE  
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese  
në llogarinë postare (conto corrente postale)  
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

Telefono në redaksi dhe kërkto të të nisim numrin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.  
Më ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.



BOTA SHQIPTARE, VIALE MARCO POLO 119, 00154 ROMA

REDAKSIA DHE SHËRBIMI I ABONIMEVE TEL 06-57289240 - FAX 06-62209543 - CEL. 339-6426836

redaksia@botashqiptare.net





# ANILDA IBRAHIMI

## “Italisht, por me temë shqiptare”

Pas romanit befasues “Rosso come una sposa” shkrimtarja shqiptare më banim në Romë penë italiane i kthehet lexuesit me “l'Amore e gli stracci del tempo”. Botuar sërish nga Einaudi, edhe pse i shkruar drejtpërdrejt në italisht, është sërish një temë dashurie dhe dhimbjeje që vjen nga Ballkani.

**Shqiptari i Italisë:** Mëse një vit më parë doli romani “Rosso come una sposa” ambientuar në një krahinë të Jugut shqiptar. Në këtë të dytin ke kaluar nga Shqipëria në Kosovë, duke trajtuar plagën e fundit të Ballkanit përmes dy të rinjve e familjeve të tyre... Përse kjo zgjedhje?

Anilda Ibrahim: Kur doli romani im i parë shpesh shtypi italian më bënte pyetjen: Kur një libër i ambientuar në Itali? Dhe unë përgjigjesha se kam akoma shumë tema që i perkasin Ballkanit, kështu që mund të flasim pas disa vitesh... Në fakt Ballkani për mua është histori, ngjarje, folklor, baladë,



dhimbje, plagë e pasion, nga ato pasionet që të lënë pa frymë. Gjatë shkrimit të këtij libri kam vuajtur me të vërtetë, shpeshherë në përditshmërinë time thërrisja familjarët e mi me emrat e personazheve të librit. Kam ecur mbi një fill tejet të brishtë, e bindur që për mua kjo mënyrë të treguari ishte e vetmja. Nuk më pëlqejnë librat me personazhë të këqij, personazhet e mi janë persona që gjenden në mes të Historisë, që nuk kanë zgjedhur të jetojnë dramën e kohës, por koha ka zgjedhur për ta. Doja të tregoja dramën e Kosovës, por jo duke vënë në qendër serbët dhe retorikën e luftës. Kam vënë në

qendër dy të rinj të cilëve lufta u ndryshon fatin dhe koha e pamëshirshme siç di të jetë vetëm ajo, u copëton ëndrrën që i mbajti në jetë, dashurinë e tyre.

Në libër bën pershtypje harku kohor që ndjek fatin e këtyre dy familjeve. Je nisur nga Jugosllavia e Titos për të mbërritur në ditët tona. Edhe në librin e parë, bën pershtypje sfondi historik që ti u jep ngjarjeve që tregon.

Historia është shumë e rëndësishme për mua. Më intereson pa masë, ndërthurja e ekzistencës sonë me historinë, me

vijon në faqen 20

**ANILDA IBRAHIMI**

vijon nga faqja 19

"H" të madhe. Ne gjendemi në mes të saj pa e kuptuar dhe në distancë e marrim vesh sa ka ndikuar ajo në jetën tonë. Më pëlqen toni prej ngjarjeje të vërtetë që marrin ngjarjet që tregoj, ato janë fryt i fantazisë sime por gjithsesi lexuesit orientohen më mirë duke imagjinuar çfarë ndodhte realisht në atë moment. Në hapësirën e kohës që përfaqon libri im, jam përpjekur të tregoj ndryshimet në Ballkan, diçka vdes në thellësi të këtij gadishulli që gjithmonë është në qendër të lëvizjeve të mëdha historike. Është një vdekje që konsumohet edhe në miqësinë e vërtetë të Besorit dhe Miloshit, në dashurinë e fëmijëve të tyre Ajkuna e Zlatan, në vërshimin e fateve të humbura drejt Europës në periudhën post-titoiste dhe në rikrijimin e vendeve, kufijve, familjeve... Me pak fjalë mund të them që në këtë libër historia nuk është më e fortë se dashuria, por që të dyja janë më të pafuqishme se koha... (la storia non è più forte dell'amore, ma entrambi sono più deboli del tempo).

**Ka ndonjë ngjarje të vërtetë, konkrete, që të ka shtyrë të shkruash këtë roman?**

Në vitin 1999 gjatë luftës në Kosovë, unë punoja në Këshillin Italian për refugjatët. Kam asistuar mbërritjen e refugjatëve në Comiso (Sicilia), kam dëgjuar historitë e tyre dhe kam ndjekur rrugën e integritetit të disave apo të ikjes nga Italia për t'iu bashkuar të afërmeve në Gjermani apo Zvicër të tjerëve. Kam dëgjuar aq shumë nga jeta e tyre që në një moment e kuptova që duhet të gjeja mënyrën për t'i treguar ato, për t'i bërë të njohura për publikun. Nuk është vetëm akt bujarie nga ana ime por edhe detyrë, sepse shkrimtarët dhe artistët duhet t'u kthejnë njerëzve atë që marrin prej tyre. Shpeshherë në zyrën time në Romë më ka qëlluar të dëgjoja edhe historitë e djemve apo familjeve serbe të ikur edhe ata nga lufta, persona të dëshpëruar që s'kishin asgjë të përbashkët me politikën e Milosheviçit. Në ato momente pyesja veten nëse isha në gjendje të kapërceja ndjenjën time nacionaliste dhe t'i trajtoja siç trajtoja të tjerët. Të njëjtën gjë ven-



dosa të bëj kur shkrova këtë libër.

Përsëri italisht, ashtu si libri i parë. Mos vallë shqipja nuk është më gjuha jote e ndjenjave, apo siç thuhet ndryshe, ke filluar të ëndërrosh në italisht?

Edhe librat e ardhshëm do të jenë në gjuhën italiane. Le të lëmë ndjenjat mënjane dhe të bëjmë një diskutim logjik: a ka nevojë të shkruaj unë në shqip për të rrëfyer Shqipërinë e sotme? Ajo ka shkrimtarët e vet që ndjekin përditshmërisht zhvillimin e saj, shoqëror, kulturor dhe politik, unë kam 15 vjet që kam ikur ç'mund të

them për të? Gjuha letrare zhvillohet, kuptime të reja hyjnë në të, unë ç'mund të di? Kthehem rrallë, bëj pjesë në kategorinë e familjeve të përziera dhe detyrimisht respektoj më zgjedhjet e të gjithë pjesëtarëve të familjes, por në ato 15 ditë që kthehem unë, sinjerisht nuk jam në gjendje të thih të rejtat dhe të karikohem aq sa më mjafton për të shkruar romanet e mia. Më ka qëlluar rasti të lexoj një gazetë shqiptare on line, që imponon italishten si gjuhë komunikimi dhe ku pjesëmarrësit më fyejnë me fjalë vërtet të rënda për zgjedhjen e italishtes si

gjuhe letrare. Paradoxke shqiptare? Me këtë rast u them të gjithë lexuesve të mi, që nuk ka asnjë akt tradhtie nga ana ime drejt gjuhës mëmë. Zgjedhjen time e shoh si përlulje të një personi të ndërgjegjshëm që e do gjuhën e vet në atë farë menyre sa të hiqet mënjane duke thënë: unë s'jam në gjendje, ka të tjerë që e bëjnë më mirë se unë, Shqipëria ecën përpara edhe pa mua! Nuk jemi të pazëvendësueshëm... Pastaj ky fenomen është shumë i përhapur në të gjithë perëndimin. Franca ka Milan Kunderën, Zvicra Agotta Krisof, Anglia Zadie Smith e Hanif Kuneishi. Emblematik është rasti i fitores së Nobelit të këtij viti nga Herta Mueller, ex-citadina romena. "Atdheu është çka flitet" deklaroi në momentet e para të fitores. Atiq Rahimi, afgano që shkruan në frëngjisht, me librin "Guri i durimit" fitoi çmimin më prestigjioz në Francë për vitin 2008, Concourt. Pra është një fenomen global nga ku nuk mund të përjashtohemi ne shqiptarët.

**Sa e përdor shqipen në jetën e përditshme? A ndjek televizionin, shtypin shqiptar?**

Gjuhën shqipe në përditshmërinë time e përdor pak, fare pak. Në fillim u përpoqa t'i mësoja shqip tim shoqi, por hoqa dorë. Italianet për gjuhë të huaja nuk janë shumë të

vijon në faqen 23



Edhe librat e ardhshëm do të jene në italisht. Le të lëmë ndjenjat menjane dhe të bëjmë një diskutim logjik: a ka nevojë të shkruaj unë në shqip për të rrëfyer Shqipërinë e sotme? Ajo ka shkrimtarët e vet që ndjekin përditshmërisht zhvillimin e saj, shoqëror kulturor dhe politik, unë kam 15 vjet që kam ikur ç'mund të them për të?







# WIND

## EASY ROAMING FLET SHUMË, SHPENZON PAK.

ME 5 EURO NË MUAJ MUND TË MARRËSH TELEFONATA DHE T'U TELEFONOSH  
NGA JASHTË TË GJITHË NUMRAVE ITALIANË ME VETËM 15 QINDARKA NË MINUTË, PAS MINUTËS SË PARË TË BISEDËS.  
DËRGO NJË SMS ME TEKSTIN "EASY ROAMING SI" NË NUMRIN FALAS 4033.

PËR INFORMACIONE [WIND.IT](http://WIND.IT)



a mund të dërgoj para  
në **shqipëri** me

**7€\*** komision?



tani edhe nga **toskana**

shuma	komision*	shuma	komision*
€0,01 - €100	€7,00	€400,01 - €600	€26,00
€100,01 - €200	€10,00	€600,01 - €800	€34,00
€200,01 - €300	€13,50	€800,01 - €1.000	€44,50
€300,01 - €400	€17,00		

oferta është e vlefshme nga 24 marsi 2009 në të gjitha agjencitë western union në lombardi, emilia romagna, piemonte, liguria, valle d'aosta, trentino alto adige, veneto, friuli venezia giulia dhe toskanë.

\* fondet në përgjithësi janë të disponueshme në pak minuta në varësi të afatave dhe kushteve të shërbimit, duke përfshirë dhe oraret e agjencive si dhe ndryshimet në çmimet lokale, për më tepër shikoni formularin e dërgesës për kufizimet. \*\*përveç komisionit, western union përfiton para shtesë kur këmben paratë tujaja në monedhen vendase. Komisionet standarte fillojnë me 1000.01 euro të dërguara në një transakcion. Për listën standarte të komisioneve ju lutemi, vizitoni agjencitë tona.

**WESTERN UNION** | *yes!*

familja juaj mund t'ju ndiejë pranë me një transfertë parash, kudo që ju mund të ndodhëni.

+355 42 23 49 79

transfertë parash

gettare negli appositi cestini per proteggere l'ambiente.

www.wu.it

© 2009 WESTERN UNION HOLDINGS, INC. All rights reserved.



vijon vijon nga faqja 20

prirë! Ai thotë që nxënësit e paaftë janë sinonim i paaftësisë së mësuesit e ndofta ka të drejtë... Me fëmijët më ndryshe. Me vajzën flas, por më përgjigjet italisht. Këtë e vërej edhe në familje të tjera shqiptare, brezi i dytë i lindur në këtë vend, italishten e konsideron në njëfarë mënyre si gjuhën e nënës, dhe shqipja bëhet si gjuhë e huaj që ia vlen të mësohet. Shtypin shqiptar e ndjek nëpërmjet internetit, ndjek edhe Botën shqiptare sepse më jep masën e integritetit të komunitetit shqiptar si dhe problematikat që kanë të bëjnë me të. Kanalet televizive shqiptare nuk e ndjek, sepse nuk ndjek televizionin në përgjithësi, përveç emisioneve të veçanta në kanale si BBC apo National geographic. Televizioni i sotëm është pasqyrimi i të keqes që ka goditur shoqërinë. Në të gjitha konferencat e mia u bëj thirrje të rinjve të marrin distancat nga programet e tronistëve të Maria de Filipit e të tjera programe si ky. Jeta reale është tjetër gjë, Italia e sotme është e mbushur me probleme dhe sikur ka humbur nga sytë edukimin e të rinjve që u ka mbetur të edukohen nga televizioni komercial. Nuk e kam idenë sa është goditur televizioni shqiptar nga ky fenomen, uroj me gjithë zemër që të mos ketë marrë dhe imituar të këqijat e perëndimit.

**A është botuar ndonjë libër i yti në Shqipëri, i përkthyer në gjuhën shqipe?**

Deri tani, as libri im i parë nuk është botuar në Shqipëri. Einaudi është kontaktuar nga shtëpi botuese të ndryshme por nuk kam pranuar unë dhe ata kanë respektuar dëshirën time. Mënyra e të treguarit tim nuk i përshtatet gjendjes shpirtërore që populli shqiptar kalon në këto momente. Tonet e mia nuk janë retorike, nuk kanë për qëllim hakmarrjen në largësi të mërive të vjetra politike, unë rrëfej thjesht për kënaqësinë e rrëfimit.

Kam lexuar komente nga lexues shqiptarë ku thonë se bëj apologjinë e komunizmit, apo se kam dëshirë të rehabilitoj vitet e diktaturës. Unë kam treguar diktaturën në atë masë që ajo ka kushtëzuar jetën time, në atë masë që ishte pasqyruar në përditshmërinë time. Personalisht, e dënoj komunizmin siç dënoj çdo lloj diktature në botë, por kjo nuk më pengon të



**Rosso come una sposa ka vajtur jashtëzakonisht mire. Keto dite bashke me librin e ri, u ribotua ne versionin Tascabile- Einaudi. Ka qene nje nga librat me te shitur per 2008 dhe eshte perkthyer ne shume vende si: Gjermani, Finlandia, Polonia, Israele etc. Ka fituar gjithashtu shume çmime letrare**



them që diktatura tek ne kishte mbështetjen dhe admirimin e gati një populli të tërë. Për t'u kthyer tek pyetja, mund të them që publiku shqiptar nuk mund të marrë distancat kaq shpejt nga e kaluara e tij dhe të shohë me gjakftohtësi periudhën diktatoriale. Kështu që tonet e mia të qeta janë pa vend në atë kontekst.

**Si ka shkuar libri i parë?**

"Rosso come una sposa" ka shkuar jashtëzakonisht mirë. Këto ditë bashkë me librin e ri, i pari u ribotua në versionin Tascabile - Einaudi. Ka qenë një nga librat më të shitur për vitin 2008 dhe është përkthyer në shumë vende si: Gjermani, Finlandia, Polonia, Israele, etj.

Me librin e parë kam fituar gjithashtu shumë çmime letrare si: Edoardo Khilgren - Città di Milano; Corrado alvaro, Città di Penne, Giuseppe Antonio Arena dhe së fundmi këto ditë La Magna Capitana. Jam pamasë e kënaqur dhe përfitoj të përsëndes nga faqet e gazetës ata që më kanë lexuar dhe shpesh dërguar letra të mrekullueshme mbushur me afekt ku më thonë se gjejnë veten në personazhet e mi. Mendoj që ky është çmimi më i madh për një shkrimtar.

**Projekte të ardhshme? Mos duhet të presim ndonjë roman të ri për vitin e ardhshëm?**

Po shkruaj librin e tretë, që mbyll trilogjinë. Edhe pse trajtoj tema të ndryshme, bashkë me dy të parët, dhe ky që po shkruaj, janë pjesë e një trilogjie. Isha nisur nga vitet '900, nga shoqëria arkaike dhe e mbyllur e një krahine shqiptare duke shoqëruar mbërritjen e saj në modernitet. Në librin e dytë trajtoj shpërbërjen e Ballkanit, pra fundin e shoqërive të bazuara në koncepte etnike dhe daljen në një botë europeiste. Personazhet e "L'amore e gli stracci del tempo" përfaqësojnë paradigmen e çrrënjosjes totale, atje ku ky koncept nuk vesh vetëm një karakter kultural, por na çon sërish në fushën e larmishme dhe të gjerë të problematikave migrante ku merr ngjyrimë që janë më të prekshme e më të thella. Libri i tretë është nga ana e fëmijëve, brezi i fundit i lindur tjetërkund, në njëfarë mënyre kthimi - jo fizik - në origjinën e tij, ndërgjegjësimi. Kaq nuk mund të them më tepër.

**C**osi vicina, così lontana" kështu titullohet një ekspozitë që do të zhvillohet në Genova nga 12 nëntori deri në shkurt të vitit që vjen. Shqipëria e pas komunizmit dhe e demokracisë së sapombërritur, siç nëntitullojnë edhe vetë organizatorët e ekspozitës synon të hedhë dritë mbi fqinjën më të afërt e njëkohësisht më të panjohur të Italisë, Shqipërinë. Në ndodh shpesh që Shqipëria të ofrohet e plotë në një ekspozitë arti në Itali si protagonistë e vetme dhe eskuzive e saj e aq më pak ndodh që si zëdhënës të saj të jenë një grup artistësh të rinj, të panjohur që sjellin Shqipërinë e tyre me mjetet e artit bashkëkohor i cili ka zbarkuar në Shqipëri bashkë me demokracinë në kohën e paskomunizmit por duke zënë rrënjë e duke korur shumë më tepër sukses se e para. Do të jetë pikërisht Shqipëria e paskomunizmit ajo që artistët e rinj shqiptarë kanë vendosur t'i tregojnë Italisë, në bashkëpunim me Museo d'arte contemporanea



"Cosi vicina. Così lontana. Arte in Albania prima e dopo il 1990" Ekspozitë në Muzeun e Artit Bashkëkohor Villa Croce në rrugën Jacopo Ruffini 3, Genova +39 010580069 +39 010532482 (fax) www.museovillacroce.it nga data 12 nëntor 2009 deri më 7 shkurt 2010

## KAQ AFËR, KAQ LARG

### Arti shqiptar para dhe pas 1990-ës vjen në Genova

di Villa Croce me galerinë kombëtare të Tiranës dhe Akademinë e arteve po të Tiranës. Sepse Shqipëria e pas komunizmit është një kantier gurgullues që për mendjen e ngadalta të atyre që dijnë të dëgjojnë ritmet e çfarë vërshon përreth, ofron shumë spunto për tu shënuar, përpunuar e shprehur lirisht në mënyrë kreative e të personal-

izuar siç meritojnë kohërat interesante të pas-komunizmit. Kujtim Buza, Klirim Ceka, Perikli Culi, Driant Zeneli, Elsa Martini, janë vetëm disa prej emrave që janë bërë interpretues të lirë të Shqipërisë në ekspozitën "Cosi vicino, così lontano"

(Në foto, Çifti, punë nga Elsa Martini)

Dal 6 all'8 novembre viaggiatori e scrittori di viaggio, reporter e fotografi si incontrano in Friuli Venezia Giulia per la quinta edizione della manifestazione tra incontri, presentazioni di libri, proiezioni e letture: oltre 40 appuntamenti con giornalisti, scrittori, studiosi, fotografi e viaggiatori.

Il tradizionale "Focus" di Fuorirotta (domenica 8, dalle 14) sarà dedicato quest'anno all'Albania, paese che ci è geograficamente vicino, ma di cui ancora, in gran parte, ignoriamo la storia, la cultura, il patrimonio naturale e archeologico. In Italia gli albanesi oggi sono circa 450 mila. Per anni si sono sentiti come "in missione" per conto delle famiglie rimaste in patria: una provvisorietà che alla fine di ogni mese spediava a casa gran parte del guadagno e che costituiva gran parte della ricchezza dell'Albania. Ma la provvisorietà è lentamente svanita. Ora hanno qui le loro mogli; e i loro figli parlano la nostra lingua quasi meglio dell'albanese. Che cos'è per loro oggi l'Alba-

ERE

Provoje menjëherë!

### MERRE ME VETE ËNDRRËN TËNDE.

Vinci per la vita-Win for Life është një lojë e thjeshtë dhe argëtuese që bazohet tek numrat, nëpërmjet së cilës mund të fitosh shumë çmime dhe një super çmim prej 4.000€ në muaj për 20 vjet, për të realizuar të gjitha ëndrrat e tua.

**10 numrat që të ndryshojnë jetën.**

Të luash dhe të fitosh me Vinci per la vita-Win for Life është shumë e thjeshtë: zgjidh 10 numra nga 1 në 20 dhe gjej se cilët janë numrat me fat. Terminali i lojës do t'i caktojë lojës tënde atë që quhet Numerone, një tjetër numër nga 1 në 20 që bën të mundur fitoren e çmimit të parë Vinci per la vita-Win for Life: deri **4.000€ në muaj për 20 vjet**. Mund të luash 1€ për çdo dhjetëshe numrash të vënë në lojë dhe të fitosh kështu 10, 9, 8 dhe 7 numra të saktë. Ose 2€ për çdo dhjetëshe numrash dhe të dyfishosh mundësitë për të fituar, me 10, 9, 8 dhe 7 bile dhe me numra të saktë, si 3,2,1 dhe 0. Ke luajtur 1€ dhe ke kapur 10? Ke luajtur 2€ dhe ke kapur 10 ose 0? Nëse Numerone që del është i yti, und të fitosh deri 4.000€ në muaj për 20 vjet.

**Jeta jote e re fillon menjëherë.**

Ke shumë mundësi: ka 13 nxjerrje numrash, një çdo orë, nga ora 8.00 deri në 20.00, çdo ditë të javës. Nëse zgjedh Abonimet, mund të përsëritësh lojën për 2, 3, 4, 5, 10 konkurse, ose për gjithë konkurset e ditës, gjithë konkurset e dy ditëve bile edhe të të gjithë javës. Gjithashtu mund të luash në të njëjtën skedë deri në një maksimum prej 14 numrash, duke vënë në lojë kështu sisteme numrash të integruara që do të të japin akoma më shumë mundësi për të fituar. Personalizojë lojën tënde: me shumë opsione loje, rastet e fitores nuk mungojnë.

Të çliuar dhe të rregulluar.

I ke zgjedhur numrat e tu me fat?

Mendo se ç'mund të bëje: të blesh një shtëpi për familjen, për shembull, ose të hapësh një biznes tëndin. Zgjidh numrat që për ty kanë domethënie të veçantë: numra me fat sipas traditës së vendit tënd, një datë të rëndësishme, ditëlindjen e një njeriut të dashur. Mund të jenë numrat e duhur për të fituar! Dhe nëse blen kartat me numra të kombinuar automatikisht aty për aty në qendrën e lojërave, argëtimi është më i madh: duhet të vendosësh vetëm se sa do të luash dhe të provosh emocionin e të besuarit tërësisht në dorë të fatit.

Bli menjëherë një lojë:  
**Vinci per la vita-Win for Life e gjen në të gjitha qendrat e lojërave Sisal.**

Sisal është një kompani lojërash por edhe një rrjet në shërbim të qytetarëve me një ofertë të plotë dhe të posaçme që sot përbëhet nga rreth 240 shërbime aktive. Shumë prej këtyre shërbimeve janë futur në rrjetin e qendrave tona për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të të huajve në Itali, si: skeda rimbushëse për telefona celularë, karta telefonike ndërkombëtare më të besueshme dhe të leverdisshme, shërbim i transferimit të parave në kohë reale në botë dhe dërgim i zarfave dhe i pakove në Itali dhe jashtë saj.





## GENTI TAVANXHI NJË SKULPTURË E TIJ NË KISHËN E NORCIAS

**D**o të mbajë veprën e një skulptori shqiptar kisha e Castelluccio-s në Norcia. Bëhet fjalë për skulptorin nga Shkoder, Genti Tavanxhiu i cili prej vitesh jeton tashmë në Itali. Por veprat e tij nuk gjenden vetëm në Itali, e në Shqipëri por edhe në Gjermani, Zvicër e më gjerë. Ndërkohë që të shumta janë edhe konkurset dhe ekspozitat artistike ku skulptori shqiptar ka marrë pjesë me punët e tij të një karakteri të shumëllojshëm në përzgjedhjen e teknikave dhe tematikave.

Profili kryesor i artistit shqiptar duket se është skulptura publike ku ai lëviz nëpër zhanre të ndryshme të artit bashkohor duke shprehur përmbytje konceptuale të atyre që janë rripjet më tipike të arteve të bukura të shekullit të njëzetën por edhe të një forme të artit disi më klasike e më të kombinuashme me kryeveprat e artit të së kaluarës veçanërisht një një vend me pasuri të jashtëzakonshme në këtë drejtim



siç është Italia. Dhe pikërisht ky aspekt është ai që i ka sjellë artistit shqiptar nderin e të ekspozuarit në një nga kishat më spektakolare të Italisë, ndërtuar në vitet 1500 në një fshat të Norcias, të quajtur Castelluccio. Do të jetë pikërisht një shën Mari klasike e ndërthurur me elemente të hijshme të simbolizmin të vjetër të krishterë e të parakrishterë ajo që do të shtohet nga ana e artistit shqiptar në kishën e zonës së Norcias. Bëhet fjalë për një skulpturë në përmasa reale 165 centimetër të lartë, që përfaqëson një shëmbëllturyrë klasike të figurës kyçe të krishtërimit.

nia? E come vengono visti dagli albanesi "rimasti"? Che idea avevano dell'Italia prima di passare l'Adriatico? E quale opinione hanno oggi di noi? E ancora, cosa è già europeo in Albania e cosa ancora no? Chi è già in Europa e chi ne è ancora fuori? Quanto sono europei gli scrittori, i registi, gli artisti albanesi? E quanto lo sono i politici, quelli che governano e quelli che si oppongono?

A Fuorirota ne parleranno la scrittrice Ornella Vorpsi,

l'intellettuale Kutjtim Cashku, il giornalista e documentarista Roland Sejko, il regista Artan Minarolli e l'antropologo Francesco Vietti, introdotti dal giornalista Antonio Caiazza.

Sempre per il Focus, ancora in programma la proiezione di film e documentari, tra cui Albania, il paese di fronte di Roland Sejko e Mauro Brescia, in collaborazione con Cinecittà Luce, che aprirà ufficialmente il Focus Paese, sabato sera alle 21.30.

MEDFILM FESTIVAL ONLUS

Via Nizza 92, 00198 - Roma  
TEL +39 06.85354814  
FAX +39 06.8844719  
info@medfilmfestival.org

**AMICI...FEI**

**PROGETTO PER L'INTEGRAZIONE AGEVOLATA E CONSAPEVOLE**

destinato agli adolescenti (14-18 anni) e le giovani donne (14-29 anni) immigrati  
Settembre - Dicembre 2009

Workshops provinciali: Alessandria - Macerata - Bari  
Workshop nazionale: Roma

Progetto co-finanziato dall'Unione Europea  
Presidenza del Consiglio dei Ministri  
Struttura di Missione "Dipartimento della Gioventù"  
Ministero dell'Interno  
Dipartimento Libertà Civili e Immigrazione

**FONDO EUROPEO PER L'INTEGRAZIONE DI CITTADINI DI PAESI TERZI**

- Permessi di soggiorno
- Cittadinanza italiana
- Lavoro - Imprenditoria
- Assistenza commerciale e finanziaria
- Assistenza legale sindacale
- Assistenza sanitaria e sociale
- Consulenza fiscale
- Assicurazioni e fidejussioni
- Affitti e compravendite casa
- Pensioni nazionali e internazionali
- Educazione
- Mediazione interculturale
- Pratiche auto - Patente
- Formazione professionale
- Viaggi e turismo
- Traduzioni lingue straniere
- Marketing multimediale
- Organizzazione eventi culturali
- Onoranze funebri

**NECS MEDI**  
Tel. 06.44243019 - email: info@necsmedi.com  
www.necsmedi.com



# 1989-2009 20 vjet pas rënies së murit

Marjola RUKAJ, Berlin

Berlini është shndërruar në një muze në qiell të hapur i gjithë i kushtuar murit dhe asaj pjese të historisë që i ka latuar identitetin qytetit, në të kaluarën e në të tashmen. Gjithë vitin 2009 e veçanërisht tetori janë një periudhë kremtuese e njëzetvjetorit të rënies së murit që pikërisht këtë qytet e ndante frustrueshëm në dy pjesë pak komunikuese midis tyre, duke e shndërruar në një pikë gjeografike ku lufta e ftohtë materializohet e bëhet e prekshme. Kjo është ajo që duan të kujtonë dhjetëra ekspozitat dhe performancat që gjenden kudo nëpër qytet të mbushura me foto konceptuale, apo foto të epokës, njerëzish të zakonshëm, politikanësh që iu dorëzuan historisë si mur-ndërtues, mur-vrojtues apo mur-shkatërrues, ndërsa ngado shihet bardhë e zi entuziazmi i lindorëve e perëndimorëve në ato ditë të para njëzet vjetëve kur gjermanët u bënë sërish një komb, dhe qyteti gëlonte me parrullat "wir sind ein Volk". Ato ngjarje kanë shndërruar Berlinin në një qytet simbol, dhe në një ishull mes dy botëve e sot mes vetë Gjermanisë një përjashtim i dukshëm e i dallueshëm nga skemat dhe frenetizmi i disiplinës dhe produktivitetit gjerman. Edhe pse jo fort tërheqës krahasuar me të tjera qytete tradicionalisht turistike, kryeqyteti rishtas i Gjermanisë së bashkuar tërheq pikërisht për atë rëndësi që historia i ka caktuar nga koha e luftës së ftohtë. Ndërsa pikërisht për këtë arsye ai është shndërruar në një kryeqytet kulturor të Evropës së pas murit. Rënia e murit dhe ajo që mbeti në historinë e në psikozën e për-bashkët të gjermanëve si Die Wende, ndryshimi, ka bërë që qytetit t'i buzëqeshë fati e t'i rikthehen hiret që kish humbur në kohë të largëta që nga ardhja e nazistëve në pushtet.

Një Gjermani shumë gjermanë

Për të kujtuar një nga ditët

vendimtare që ndryshuan rrjedhën e historisë, në 2 dhe 3 tetor Berlini i shndërruar në një hapërsirë monotematike, ripërtëjtoi atë takim historik ndërmjet Willy Brandt dhe Helmut Kohlit në pikën nevralgjike ndarëse e bashkuese midis dy anëve të qytetit, në portën madhështore të Brandeburgut. Por më shumë se diçka përkujtuese, bëhej fjalë për një vepër arti të një artisti spanjoll që me silueta gjigande kishte animuar personazhet protagoniste të atyre ditëve. Ishte një performancë e përcjellë nga mediat drejtëpërdrejtë, si e tillë, ndërsa në sfond imazhet shoqëroreshin me analiza kritike. Sepse pothuaj njëzet vjet pas rënies së murit, dhe takimit aq përmallës të liderëve që shqiptonin: Wir sind ein Volk, gjërat kanë ndryshuar dhe muri edhe pse i zhdukur e i copëzuar në mijëra suvenirë që ende nuk janë sosur edhe sot e kësaj dite, ka lënë pas një gjurmë të thellë e të pashlyeshme. Gjermania ishte në ato ditë vendimtare të vdekjes së murit, një projektion në miniaturë i gjithë Evropës, dhe pjsërisht e tillë mbetet edhe sot. Sepse Evropës iu zhduk kordoni që e diseksiononte për aq vjet, por vështirë të thuhet se perëndimi e lindja janë unifikuar sikur asgjë të mos kish ndodhur edhe brenda Bashkimit Evropian të aq ëndërruar nga të ardhurit e rinj. Dhe kështu vazhdon të jetë. Krahas identiteve



”

Reportazh nga Berlini, aty ku njëzet vjet pas rënies së murit, perceptimet janë shtresëzuar dhe paragjimeve u bëjnë bisht vetëm brezat më të rinj, që nuk kanë njohur as mur, as lindje e as perëndim

humë të forta krahinore që gjithmonë kanë karakterizuar gjermanët, me rëniën e murit ayre iu shtua edhe gjeografia në lidhje me murin, lindje apo perëndim. Kështu gjermanët sot ndahen në Ostler (lidnorë) dhe Westler (perëndimorë) ndërsa të dyja palët me shpoti thërësin njëri-tjetrin përkatësisht Ossi dhe Wessi. Sepse nuk është njësoj të jesh lindor, apo perëndimor. Ndërkohë që dashuria instiktive e ushqyer politikisht gjatë viteve të ndarjes nga politikanët largpamës, është shndërruar në një idiosinkrasi reciproke, të prekshme që nga repertori i gjerë i barsaletave me të cilin secila nga palët përgojon tjetrin. Një shtet dhe dy botë, thonë studiuesit e fenomenit. Ndërsa difidenca mban të gjallë fantazmën e murit, dhe sociologët e i kanë vënë emirn "Die Mauer in den Koepfen" ( Muri në kokat e njerzve). Sepse gjithë gjermanët që janë më shumë se 20 vjeçarë e kanë të vështirë të shikojnë përtej murit pa përdorur skeletë stereotipes të stazhionuara, nga moskomunikimi i gjatë, dhe ndryshimet e mbrujtura ndërkohë.

Duke çaluar nga lindja

Mjafton të kapërcesh dytëlëshin e ngulur në asfalt në vend të murit nëpër Berlin, për të kuptuar se je në lindje, në një tjetër vend. Mbizotërojnë bulevardet gri me artin gjeometrik perfeksionist të diktaturave që sfidojnë përmasat njerëzore me madhësinë e tyre. Dhe kështu shtrihet e gjithë lindja, e tronditur dhe e zhgënjyer nga diferenca ekonomike e theksuar krahasuar me simotrën e saj perëndimore. Gjermania lindore pësoi pak a shumë të njëjtat procese degradimi psiko-ekonomik që pësuan edhe shumë vende të tjera të Evropës në lindje të murit, duke nisur që nga dalja në pension e gjithë industrive të pamirëmbatjura e në prag kolapsi, deri në emigracionin në masë që përfshiu gjermanët lindorë menjëherë pas hapjes me sivëllezërit perëndimorë, deri sa për vite imazhi i lindorit ishte një flokëgjatë dalëmode veshur me tuta fosforeshente fiskulture blerë në diskontin më të papërfillshëm të qyteteve. Ndërsa edhe pse lokomotivë e lindjes evropiane së bashku me Jugosllavinë e atëhershme, ekonomikisht ish republika demokratike ishte shumë larg republikës federale. Mirëpo një komb, një ekonomi, dhe erdhiu vetiu edhe prekja e shkopit magjik që njësoi markën lindore me atë perëndimore, deri sa koncepti i barazisë në zhargonin e përditshëm të gjermanëve tashmë ndryshe thuhet "eins zu eins", një me një. Ende gjermano-perëndimorët vazhdojnë të ankohen se taksat e tyre shkojnë për të mbushur xhepat e shpuar të lindorëve të vobektë, ndërsa edhe pse rimëkëmbja e Gjermanisë lindore që më e shpejtë e më e suksesshme se e shumicës së vendeve të tjera të Evropës lindore, e parë nga jashtë, impakti që tejet negativ për gjermanët e përkëdhelur nga mirëqenia dhe shteti social më bujar në Evropë. Kështu, sivëllezërit përtej murit u shndërruan në kushurinjtë nga



fshati, që përdhosën qytetarinë borgjeze me këpucët e tyre të përbaltura, dhe varfërinë e tyre turpëruese. Njëzet vjet pas rënies së murit, perceptimet janë shtresëzuar dhe paragjymeve u bëjnë bisht vetëm brezat më të rinj, që nuk kanë njohur as mur, as lindje e as perëndim.

Ostalgie, me apo pa mur

Viteve të fundit pjesën më të madhe të Evropës lindore me ndonjë përjashtim sporadik si Shqipëria, e ka kapluar përmallja, për atë që ishte, e gjithçka që kishte kur muri lartohej kërcënues bash në mes të Berlinit. Kohët e qeta, kur të gjithë ishin të vëllazëruar, ritmet e ngadalta të jetës së sigurtë, mefshtësinë e marrëdhëniesve seksuale, strukturat shoqërore siguruese, e madje edhe turshinë e tejkripura të sallatorëve. Një tufë ankesash të pavdekësuar para pak vitesh deri në klishe nga filmi i shumëkriticuar

Goodbye Lenin. Kjo është Ostalgia, nostalgjia për lindjen (Ost), që nuk presupozon me doemos një dëshirë të marrë për të rindërtuar murin tullë përmbi tullë, për tu ktyer pas kur ishim më mirë kur ishim më keq. Ostalgia tregon se sa ka rënë muri, sot 20 vjet pas. Është rikthimi në identitet, nevoja për rihabilitim të biografisë së gjithsecilit - siç e përkufizon Christa Wolf, një mendimtare e Gjermanisë Lindore - ndërsa janë lënë pas vitet kur gjithçka që ishte perëndimore ishte flori, ndërsa gjithçka që ishte lindore

ishte e denjë për kosh plehrash, përfshirë këtu edhe të kaluarat e jetuara të njerëzve. Kështu i bie që muri të ketë rënë plotësisht dhe lindorët të jenë zgjuar në një zhgënjendër reale. Por Ostalgia është edhe shprehja e të gjendurit keq sot, në sistemin e ri, për humbjen e vlerave ende të pazëvendësuar me të tjera. Tranzicion edhe këtu si në gjithë gjysmën tjetër të Evropës.

## Kaosi pas murit

Marjola Rukaj

Këtu e njëzet vjet të shkuara muri i Berlinit ra papritur duke i çuditur të gjithë, thonë diplomatët e karrierës që tërhiqnin në ato kohëra fijet e fateve të botës. Ishin vitet '80, dhe prej kohësh ishte pjekur stabiliteti i një bote me luftë të kristalizuar e për pasojë të përgjumur nën dafina, mes dy blloqeve statikë që ruheshin, e ishin vazhdimisht në prag lufte, por që nuk do të hidhnin kurrë asnjë hap fatal siç nuk bënë në kohën e krizës së Kubës, duke qenë se armët nuk ishin më lodrat e ngadalta të luftërave të mëparshme, por gjithpushtetmëritë atomike. Kështu gjithçka ishte e qartë, e sigurtë, statike, dhe rruzul

ujt. Vdiqën ideologjitë, u hodh e tha Fransis Fukujama, i shqetësuar për mish mashin që ishte duke pllakosur gjeopolitikën botërore pas rënies së murit. Dhe për pasojë edhe partitë politike në mos vdiqën, u zhvlerësuan. Ndërsa një tjetër filozof i konfliktit, nga ata që e bazojnë ekzistencën mbi dialektitën e përplasjes, e ndoshta sintezës së të mbijetuarve, Samuel Huntigton parashikonte shpikje gjeniale të armiqve të rinj, dhe prerjen e pllakave të reja tektonike të përplashme midis tyre, këtë herë sipas parimeve të qytetërimeve në teorinë e famshme të "përplasjes së qytetërimeve". Teoritë e vërtetueshme, stisëse apo frymëzuese, qenë edhe vetë produkt i fundosjes së sistemit të vlerave dhe qartësive ndërsa kampi lindor implodonte në dhjetëra sisteme, mes boshllëkut të lënë na diktatorët e mëdhenj dhe paaftësisë së liderucëve provincialë. Dhe itineraret e pushtetit ndryshuan, ndërsa me zhdukjen e dy poleve të luftës së ftohtë të tjera pole, u fuqizuan dhe dolën në pah si qendra gravitacionale, ndërkohë u ringjall nga huret e veta gjeopolitika si shkencë e deklasuar që nga koha e fashizmave shkatërruese. Më pas me kalimin e kohës erdhën dhe armiq të rinj dhe kampe të reja me interesa të vjetra.

Ndërsa në Evropë, që deri në atë kohë përkufizohej sipas përmasave karoline duke mos përfshirë asgjë nga ç'shtrihej në lindje të Mitteleuropës, u zbulua papritur se edhe ajo pjesë ishte në fund të fundit Evropë dhe mund të shfrytëzohej si oborr gjeopolitik i 15 shteteve të atëhershme. Kurrë më parë Bashkimi Evropian nuk kishte qenë më i fuqishëm se sa në ato fillim viteve '90. Dhe ëndërrat e etërve për ndërtimin e një poli pushteti global që të mund të radhitej në rangun e ShBA-së u rizgjuan. Ishte e paimagjineshme më parë që një shtet nga Evropa lindore të radhitej në Bruksel si anëtar me të drejta të barabarta, edhe pse shtete si Jugosllavia - sipas thashethemnjës për kancelaritë indiferente ndërsa përskuqej kasaphana e viteve '90 - i plotësonin standardet e nevojshme ekonomike, e teorikisht edhe të demokracisë përfaqësuese pas vdekjes së Titos.

Por në të vërtetë gjithë Lindja implodoi, u shpërbënë e ranë në krizë shtetet shumë-etnike, dhe në Evropën lindore ku nuk qenë bërë llogaritë me fashizmin, nacionalizmi lulëzoi natyrshëm si e vetmja ideologji që arrinte të mobilizonte masat ish-komuniste. Edhe kjo Brukselin e brishtë e gjeti të papërgatitur, e madje shpesh herë për të nxjerrë nga lufta e ftohtë copëza të harruara të gjeopolitikës së Lindjes, i dha mirëbesimin pikërisht atyre që më pas do të radhiteshin në listën e kriminelëve të luftës.

Por me gjithë vështirësitë, e trashëguara nga historia, apo nga palargpamësia e burokratëve të radhës, Evropa u zgjerua pas murit. Sepse lokomotiva gjeopolitike të kësaj pjese të botës si Gjermania, zbuluan resurset që fshiheshin në lindje dhe lobuan derisa standardet dhe kritere u relativizuan dhe lindorët më afër Gjermanisë u përfshinë në konceptin e Evropës karoline, të zgjeruar nga lindja. Ndërsa për të tjerët, u ngritën të tjera mure artificiale, si Shengeni, si një arritje e madhe për ata që u rrethuan me të, por si një mur i ri konceptual për ata që mbetën jashtë. Me këtë lloj muri, sot 20 vjet pas rënies së atij të Berlinit, nuk janë mbaruar së u bëri llogaritë.



li tokësor gdhijej e ngrysej me një skemë të thënash e të pathënash të mirëditura, që i bënin lëvizjet të përlllogaritura. Kapitalizmi, komunizmi, efiçenca e armikut për kohezion brenda kampeve, dhe propaganda ishin çelësat e mbajtjes së situatës nën krontrroll.

Pastaj papritur - siç thonë dhe është tepër herët për të arsyetuar - muri i Berlinit ra, dhe strukturat solide që fiksonin ekuilibrat e luftës së ftohtë imploduan një ri pas tjetrit deri në kaos. Nuk kishte më armiq, e nuk kishte më nevojë për ideologji, e fiskulutrë cerebrale të palodhur për të bindur pop-

William Bonapace

Të gjithë e dinë ç'rëndësi ka patur televizioni si nxitës i shumë shqiptarëve për të kërkuar një jetë të re në Itali. Por asnjë nuk mund të imagjinojë ç'peshë ka patur një emision nate i radios shqiptare në imagjinarin e më pas në formimin e një djali të ri italian. Për vite me radhë, para se të lindte dielli, e, duke filluar nga vitet '70, në fshehtësi, mijëra shtetas të vendit të vogël ballkanik me përditshmërinë e tyre të mbushur me radha për bukën dhe qumështin e megjithë ndalimin e rreptë nga policia, mermin në ekranin e vogël imazhe në kontrast me jetën e tyre që vinin nga bregu tjetër i detit ku familje të pasura e të lumtura jetonin me quiz dhe publicitet. Në të njëjtën mënyrë e në të njëjtën kohë, kënga e lehtë italiane u ofronte shumë të rinjve shqiptarë, të lodhur nga rregullat estetike të vendosur nga komiteti qëndror i partisë, shijen e ndaluar të një jete ndryshe. Shpesh, ditëve të bukura të dimrit, ajo botë e fantastikuar ishte kaq e afërt sa edhe mund të shihej, apo ashtu u dukej, menjëherë përtej linjës së horizontit.

Pastaj, kur statujat e panumërta të Enver Hoxhës filluan të bien me zhurmë, duke marrë me vete edhe diellin rrezëlues të të ardhmes, antenat mundën më në fund të ngriheshin lart dhe të kapnin pa asnjë rrezik valët e huaja, ndërsa Italia u shndërrua në realitet konkret, të arritshëm brenda pak kohe: mjaftonte thjesht të kapërceheshin valët, këtë herë ato të detit. Sigurisht, shpesh zhgënjimi ka qenë tronditës; ajo botë e ëndërruar ishte vërtet ëndërr, italianët jo gjithnjë mirëpritim të ardhurit e rinj dhe shumë shpejt fërkimet u ndien. Për shqiptarët, pajtimi i virtualeve së imagjinuar për shumë vjet me realitetin nuk ka qenë i lehtë. Jo të gjithë ia dolën. Jo të gjithë deshën ta bënin. Por nuk duam të flasim për këtë. Shumëkush e ka thënë tashmë, herë për të mirë e herë për të keq. Sidoqoftë e kudoqoftë e drejta apo e gabuara, rezultat historik ka qenë që Mesdheu është shtërënguar, duke gjetur funksionin e vet të lashtë të lidhjes mes popujve dhe kulturave që lufta e ftohtë kishte ndarë aspërsisht, dhe që akoma sot njëfarë globalizimi i joekuilibruar vazhdon t'i mbajë ende pjesërisht të veçuar. Në këtë kontekst të ri burra e gra nga botë të ndryshme janë takuar dhe kanë filluar (do të më pëlqente të thoja rifilluar) të njihen dhe të përzihen mes tyre, në të mirë e në të keq. Fatkeqësisht, duhet thënë që për shumë italianë, Shqipëria ishte vetëm një shprehje gjeografike që tani po konkretizohej përmes frikës dhe shqetësimeve. Por si gjithnjë, çka është e vërtetë për shifra të mëdha nuk vlen për shumë numra të vegjël, dhe veçanërisht nuk vlen për mua.

Për mua, vendi i shqipeve, që në fëmijëri, ka qenë gjithnjë një botë plot hir, dhe kjo pikërisht pse ishte i paarritshëm. Për dekada të tëra mund të shkohej vetëm falë fantazisë në një udhëtim ëndërrash në të cilin vetëm ti e dije ç'do të takojë. Ose duhet të ishe anëtar i një grupi fanatik mikroskopik filokinez. E ndonjëherë as kjo nuk mjaftonte.

Unë nuk bëja pjesë në grupime të tilla ndaj hyrja ime në republikën e vogël ishte absolutisht e pamundur. Si rrjedhojë, Shqipëria, në imagjinatën time, ishte transformuar në ishullin që nuk ekzistonte. Në atë vend për të cilin flasin të gjithë marinaret por për të cilin askush nuk di gjë e askush nuk e ka parë.

Le të shkojmë me radhë. Gjithçka filloi shumë vjet më parë, nga fundi i viteve '70 apo në nga fillimi i atyre '80, nuk më kuj-

NOSTALGJI RADIOFONIKE

# Kur ne italianët, dëgjonim Radio Tiranën



**E famshme për të gjithë të apasionuait e radios në perëndim, Radio Tirana mbetej i vetmi zë që arrinte të depërtonte jashtë kufijve të Shqipërisë komuniste. Edhe pse e mbushur fund e krye vetëm nga propaganda, Radio Tirana jepte sidoqftë edhe ato pak elementet muzikorë që e rrisnin edhe më shumë kërshërinë e misterhme të të huajve për Shqipërinë.**

tohet mirë. Atëherë isha vetëm një adoleshent i dashuruar pas udhëtimeve dhe njohjeve, me një prirje të veçantë pikërisht për çka nuk mund apo nuk duhet të njihje.

Në të njëjtin çast kur shumë shqiptarë shihnin fshehurazi televizionin italian, duke imagjinuar një botë tjetër, ai i ri, pa mbushur ende të njëzetat që isha unë atëherë, i përkushtohej një hobby të çuditshëm, sot padyshim të pakuptueshëm prej shumëkujt. Darkave vonë ndizte radion jo aq dhe jo vetëm për të dëgjuar muzikë, por për t'u sintonizuar në stacionet e huaja: Egjipt, Bullgari, Marok... pas pak bota me gjuhët dhe atmosferat më të çuditshme mbushnin dhomën e tij duke u kapur pas mendimeve të tij më të thella. Rreth orës 11.30 ishte radha e Radio Tiranës. Në këtë rast transmetimi ishte në gjuhën italiane. Programi fillonte me notat e Internacionales. Menjëherë më pas, një zë pa aksent fillonte të fliste. Argumentet ishin gjithnjë të njëjtat: tradhtarët kinezë, revizionistët rusë, socialfashistët e Titos, fashistët italianë, imperialistët amerikanë. Fatmirësisht, Shqipëria ishte gjithnjë aty, e gatshme për të shpëtuar mbarë botën nga ky ferr shkatërrimi dhe egërsie. Ishte diçka magjepsëse! Ky vend vogël i bënte thirrje të gjithë botës, dhe meqë e bënte italisht, patjetër duhet ta bënte edhe në shumë gjuhë të tjera. Çka të bënte përshtypje nuk ishin argumentet, padyshim

propagandë e pastër, por fakti që nga errësira e netëve shfaqej zëri që vinte nga një vend për të cilin nuk dinte gjë asnjë. Nuk kishte fotografi nga Shqipëria e asnjë nuk kishte shkelur ndonjëherë atje veç ndonjë të moshuari gjatë ndonjë lufte të largët për të cilën pakkush fliste e për të cilën Italia turpërohej. Kush ishte personi që fliste në mikrofon në një gjuhë që nuk ishte e tija e që i drejtohej dikujt për të cilin nuk dinte asgjë? Kushedi nëse ai pyeste veten se cilët ishin ata që e dëgjonin, që padyshim nuk i kishte parë ndonjëherë e nuk mund t'i shihte. Ndonjëherë ishte edhe një grua që fliste kundër gjithë botës. Po përse duhej mësuar një gjuhë e huaj për të lëshuar thirrje në qiell? Kush ishin e ku jetonin këta njerëz? Një gjë është e sigurt, pas fjalëve të para mbi socialshovinizmin sovjetik mendja ime udhëtonte përgjatë rrugëve të imagjinuara të Shqipërisë. Isha betuar që atë vend duhet ta njihja patjetër. Nuk mund të ekzistonte një vend njëkohësisht kaq pranë e kaq larg sa të shfaqej e të zhdukej në zemër të natës për pak minuta!

Duke shkuar për pushime në Greqi, më qëllonte, në çastin kur anija shkonte pranë brigjeve të vendit të shqiponjave, të nxirrja dylbitë e të vrojtoja ato që më dukeshin si shtëpi. Një herë, përgjatë një rruge që i qepej malit përballë detit kisha parë një makinë që ngjitej e ngrinte pluhur. Hiri i këtij vendi të pakapshëm veç rritej. Ismail Kadare me tregimet e tij mbushte me fytyra dhe vende ato që ishin përmasa vetëm të fantastikuara. Më thënë të vërtetën qyteti i Gjirokastrës ngatërrohej me përshkrimin që Ivo Andric i bënte Sarajevos. Por nuk kishte rëndësi, edhe sot e kësaj dite jam ende i bindur që është vërtet domethënëse vetëm çka provohet në vetvete. Udhëtimi, ai i vërteti, fillon gjithnjë në brendësinë tonë. Dhe e çuditshme është që kur kam parë me sy këto dy qytete m'u dukën vërtet të ngjashme. Kisha gabuar vërtet, por vetëm pak.

Në vitin 200 kam bërë më në fund atë udhëtim aq të dëshiruar. Isha me pushime në Maqedoni pranë liqenit të Ohrit. Malet përballë ishin Shqipëria, e atëherë jepi, kapërceva kufirin dhe më në fund hëngra në një restorant në Pogradec. Një vit më pas shkova me pushime për gjithë muajin e gushtit. Saranda, Ksamili, Himara, Qiparoja, Vlora, Berati, Korça, liqeni i Prespës, Përmeti, Gjirokastra, Epiri...edhe ai mali mbi të cilin ngjitej ajo makinë shumë vite më parë.

ELLADE

viaggi

QENDËR PËR PRENOTIME TRAGETESH  
ITALI • SHQIPËRI

==> për **DURRËS**: nisje nga BARI, ANCONA e TRIESTE  
==> për **SHENGJIN**: nisje nga BARI  
==> për **VLORË**: nisje nga BRINDISI

ORARE • TARIFA • PRENOTIME:

www.elladeviaggi.it

TEL. 0836 801578 • FAX 802746 • e-mail: info@elladeviaggi.it



# ÇDO FAMILJE KA PYETJET E SAJ. PËR PËRGJIGJET ËSHTË TUTTOFAMIGLIA.



Lind Tuttofamiglia, shërbimi i ri i informacioneve dhe i këshillimit i krijuar nga Dipartimento per le Politiche della Famiglia në bashkëpunim me Inps, për t'iu përgjigjur pyetjeve të tua në mënyrë të thjeshtë dhe të shpejtë, me telefon apo internet.

Çeqe për familjen, ndihma për nënat e baballarët, kërkesa për mbështetjen e të ardhurave ... Tuttofamiglia e ka përgjigjen. Edhe për ty.

**[www.tuttofamiglia.info](http://www.tuttofamiglia.info) - contact center 803.164**



*Presidenza del Consiglio dei Ministri*  
DIPARTIMENTO PER LE POLITICHE DELLA FAMIGLIA



**Tuttofamiglia.**  
Soluzioni casa per casa.







**Dashi (21 mars - 20 prill)**

Në përgjithësi, nëntori do të jetë muaj shumë i mirë për të lindurit e 10-ditëshit të parë të shenjës dhe më pak për të tjerët. Mërkuri parashikon muaj me harxhim më të madh se zakonisht energjish dhe parash. Saturni, Neptuni, Urani dhe Plutoni do të krijojnë rrethana të favorshme për të gjithë, sidomos në dashuri.



**Demi (21 prill - 20 maj)**

Nëntori do të jetë muaj problematik për të gjithë të lindurit e shenjës dhe do të vihet në provë durimi tuaj. Vetëm gjatë 10-ditëshit të dytë të muajit, tensioni do të bjerë disi falë Jupiterit. Dielli, Mërkuri, Venusi dhe Marsi do t'ju jenë kundër gjatë gjithë muajit. Pra, sipas yjeve, nëntori duhet marrë me shumë kujdes.



**Binjakët (21 maj - 21 qershor)**

Të gjithë planetët, me përjashtim të Jupiterit, do të kenë ndikim mbi shenjën tuaj. Kundërvënia Saturn-Pluton do të jetë i rëndësishëm edhe këtë muaj, sidomos për të lindurit e 10-ditëshit të dytë. Konfigurimi i qiellit do të sjellë ngjarje të jashtëzakonshme (pozitive ose jo) për të gjithë të lindurit e shenjës.



**Gaforja (22 qershor - 22 korrik)**

Nëntori për ju do të jetë i ëmbël dhe plot dashuri. Falë Hënës do të kaloni çaste të paharrueshme në familje apo me partnerin. Dashuria do t'ju bëjë të ndjeheni mirë si me veten ashtu edhe me të tjerët. Do të jeni të hapur, të ngrohtë, plot iniciativë me të gjithë, gjë që do të çudisë ata që ju njohin për njerëz të ndrojtur.



**Luani (23 korrik - 23 gusht)**

Durimi do të jetë pika më e fortë e juaja. Dielli e Mërkuri, mund t'ju shkaktojnë nxehe të herëpashërshme. Kontrastet e ndryshme mes planetëve do të favorizojnë ngjarje mbresalënëse dhe emocione të forta. Për gjithë nëntorin do të vuani kundërvënien e Uranit dhe Neptunit, ndaj, ky muaj do të jetë plot të papritura.



**Virgjëresha (24 gusht - 22 shtator)**

Plutoni e Saturni do t'ju sjellin të lindurve të 10-ditëshit të dytë të shenjës njëfarë dobësie fizike e psikologjike ndaj ata do ta kenë të vështirë të përballojnë si duhet qoftë problemet e punës qoftë ato të jetës private. Për të gjithë është e rëndësishme të mbani parasysh se nuk duhet të hiqni dorë nga një ëndërr e vjetër.



**Peshorja (23 shtator - 22 tetor)**

Përballë kërkesave të personit që dashuron do të jeni gjithnjë në mëdyshje mes hedhjes kokë e këmbë në dashuri dhe frikës se mos e teproni. Në profesion do të tregoni aftësitë dhe kompetencën tuaj në atë çka bëni. Për formën fizike, yjet këshillojnë t'i kushtoni kohë kontaktit me natyrën për të gjetur 'bukurinë tuaj të brendshme'.



**Akrepi (23 tetor - 22 nëntor)**

Në këtë muaj të ftohtë vjeshtë siguri që nuk do të kenë pse të mërziteni. Të gjithë mund të kenë mundësi të përjetojnë çaste emocionuese me persona që deri pak kohë më parë i kanë adhuruar nga larg duke kujtuar se nuk mund t'i arrinin. Këshilla e yjeve është të tregoheni pak të kujdesshëm që të mos lëndoni dikë tjetër.



**Shigjetari (23 nëntor - 21 dhjetor)**

Të gjithë trupat qiellorë me përjashtim të Jupiterit do të ndikojnë në këtë shenjë. I rëndësishëm do të jetë veçanërisht kundërvënien e Plutoni me Saturnin kryesisht për të lindurit e 10-ditëshit të dytë. Në jetën profesionale do të hasni me vështirësi që do të mund të kapërceni vetëm me mbështetjen e kolegëve.



**Bricjapi (22 dhjetor - 20 janar)**

Vetëm Jupiteri do të jetë disi kundërvjush, ndërsa do të kenë në favorin tuaj Diellin, Mërkurin dhe Venusin të cilët do t'ju sjellin lajme të mira dhe mirëkuptim në dashuri. Jeta e çiftit do t'ju japë kënaqësi, madje kush ka ngritur familje e përpiqet ta shtojë atë, në këtë periudhë mund të ketë të reja të rëndësishme.



**Ujori (21 janar - 19 shkurt)**

Saturni, Urani, Neptuni dhe Plutoni do të jenë vendimtarë për shenjën tuaj. Marsi dhe Dielli do të ndikojnë për të gjallëruar muajin tej mase ndaj duhet të jeni të durueshëm, gjë jo shumë e lehtë për ju. Doni a s'doni ju, do të jeni protagonistë ngjarjesh që do të revolucionojnë jetën tuaj dhe të atyre që kenë pranë.



**Peshqit (20 shkurt - 20 mars)**

Në muajin nëntor do t'ju mbizotërojë Hëna që do të bëjë të mundur çaste të mrekullueshme dhe të paharrueshme, veçanërisht për gratë e shenjës. Venusi e Mërkuri do t'ju ndihmojnë të gjeni qetësi dhe ekuilibër. Por aspekt tjetër i favorshëm i qiellit tuaj do të jetë padyshim Jupiteri që do t'ju mbështesë në projektet profesionale.



Shtëpi fshati në shitje

**Montese (pr. Modena)**

Kompleks banimi krejtësisht i pavarur aktualisht i përdorur si bed&breakfast dhe banesë për pronarin. Sipërfaqja e përgjithshme 618,00 m<sup>2</sup> të ndarë në dy apartamente, tavernë-studio me shërbime, magazina dhe ish-shtojcë bujqësore tashmë e përdorur si oborr i brendshëm. Oborri dhe ndërtesa shtrihen për 1280,00 m<sup>2</sup>. E rishtrukturuar, lehtësisht e arritshme; rrugë hyrjeje private; vendndodhje panoramike. Kërkohen 965 euro/m<sup>2</sup>, cmim i diskutueshëm. E shkëlqyer për banesë, veprimtari kreative apo për aktivitetet zejtarie të vogël.

Mund ta shihni në:

<http://www.immobiliare.it/9167585-rustici-in-vendita-Montese.html>

Kontakte: Malcolm Leanza

cell. 338 9720451 / tel: 0577 943152 / fax: 0577 906077

**CATWALK**

IL NEGOZIO DI ALTA MODA



RRUGA MYSLYM SHYRI, TIRANA

ONI PUSTINA

**ERE**  
Provoje menjëherë!

Vinci per la vita  
**WinforLife!**

Të çliruar dhe të rregulluar.

**Të shohësh familjen  
një herë në vit?  
Më mirë një herë në muaj.**

**Me Vinci per la vita - Win for Life mund të fitosh  
deri 4.000€ në muaj për 20 vjet.**

Me një fitore të tillë mund të realizosh ëndrrën që ke prej kohësh  
dhe të gjitha ato që të vijnë ndër mend, të vogla apo të mëdha  
Prandaj quhet Vinci per la vita – Win for Life:  
luan një herë, fiton për gjithë jetën!

